



# ROLI DHE ZHVILLIMI I E-GOV NË SHQIPËRI

*pjesa I*

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Revista Nr.4 / Korrik 2010





*Roli dhe zhvillimi i  
E-Gov në Shqipëri  
pjesa I*

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Copyright ©  
Departamenti i Administratës Publike  
Korrik, 2010

Përgatiti për botim:  
Evis Taska, MA  
Nora Zela, MA

Arti grafik:  
Viliem Kurtulaj

**Sh**tëpia Botuese  
Itypshkronja 

DEPARTAMENT I ADMINISTRATËS PUBLIKE  
MINISTRIA E BRENDSHME  
Sheshi Skënderbej, Nr 4, Tiranë; Kutia postare Nr. 1751  
Tel: +355 4 2235937; Tel/Fax: +355 4 2251241  
[www.pad.gov.al](http://www.pad.gov.al)

## *Përmbajtja*

- 1. Zhvillimet në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe synimet për një Shqipëri në moshën Dixhitale.**
- 2. Shqipëria merr çmimin e dytë për vlerësimin e ekselencës në shërbimin publik**
- 3. Shqipëria Dixhitale**
- 4. Roli i Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHi) në zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)**
  - Strategjia për shoqërinë e informacionit, një strategji mbi parimin e gjithëpërfshirjes*
- 5. Risitë në fushën e Prokurimeve Publike**
  - Sistemi i Prokurimit Elektronik, nga sfida tek sukcesi*
  - Platforma elektronike*
  - Roli i Institutit të Trajnimit të Administratës Publike (ITAP)*
  - Rëndësia e trajnimeve për Prokurimin Publik*
- 6. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE)**
  - Nënshkrimi elektronik në e-gov*
  - Votimi elektronik edhe në Shqipëri*

## **7. Mbështetja e Donatorëve në zhvillimin e shërbimeve elektronike (USAID, PNUD, BE).**

- *USAID dhe kontributi i saj në zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit*
  - *Forcimi i shtetit ligjor dhe rritja e besimit të publikut*
  - *Rritja e efikasitetit dhe transparencës për lejet e ndërtimit*
  - *Efikasitet, transparencë dhe llogaridhënie në Administratën Tatimore*
  - *Krijimi i një procesi efektiv dhe transparent për licencimin*
  - *Rritja e besimit dhe mbikëqyrjes nga publiku*
- *PNUD dhe kontributi i saj në zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit*
- *BE dhe kontributi i saj në zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit*

## **8. Sistemet Elektronike të Manaxhimit të Dokumentacionit, një mbështetje e fuqishme për zbatimin e shërbimeve të e-qeverisjes.**



### **Zhvillimet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe synimet për një Shqipëri në moshën Dixhitale**

Shqipëria në kuadër të rrugës së saj për anëtarësimin në Bashkimin Evropian ka ndërmarrë një sërë reformash të nevojshme për t’u afruar sa më shumë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Përdorimi i teknologjisë së informacionit në vitet e fundit tregon dobinë e lartë publike të këtyre mjeteve dhe mbështetjen që ato i japin rritjes së cilësisë dhe efektivitetit në kryerjen e funksioneve publike.

Sistemet elektronike të regjistrimit e procedimit administrativ në regjistrimin e licencimit e bizneseve, kryerjen e prokurimeve publike, pagesën e taksave, regjistrin civil apo marrjen e dëshmisë së penaltetit kanë rritur ndjeshëm aksesin, lehtësinë, transparencën dhe kanë ulur kostot e marrjes së këtyre shërbimeve nga qytetarë dhe bizneset.

Përdorimi masiv i teknologjisë së informacionit po bazohet në modelin e ngritjes së rrjeteve të integruara e me të gjitha garancitë e sigurisë së ruajtjes dhe përpunimit të informacionit sipas përcaktimeve ligjore të të drejtës së informimit, mbrojtjes së të dhënave personale e informacionit të klasifikuar.

Në kuadër të këtyre zhvillimeve janë miratuar Ligji “Për Komunikimet Elektronike”; ligji “Për Nënshkrimin Elektronik”, ligji “Për Mbrojtjen

e Të Dhënave Elektronike”, ligji “Për Tregtinë Elektronike”; ligji për dokumentin elektronik, legjislacioni për krimin kibernetik dhe, së fundi ligjin për bazat e të dhënave shtetërore.

Qeveria ka miratuar një strategji të re për shoqërinë e informacionit, si dhe atë për “Shkencën, Teknologjinë, dhe Inovacionin”. Që prej tre vitesh janë themeluar Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), dhe së fundmi Agjencia për Kërkim, Teknologji dhe Inovacion (AKTI), institucioni i Ministrisë të Shtetit për TIK dhe Komunikimet Elektronike dhe Postare.

Regjistri Kombëtar është dixhitalizuar; sistemi i prokurimit elektronik është zbatuar që nga fundi i vitit 2007 dhe aktualisht të gjitha prokurimet publike realizohen në mënyrë elektronike; Shërbimi i Taksës elektronike është ofruar në vend që nga viti 2008; Deklarata doganore bëhet në mënyrë elektronike dhe Pasaportat e para biometrike janë lëshuar në fillim të vitit 2009.

Regjistrimi i bizneseve reaalizohet që prej vitit 2007 nëpërmjet procesit “one stop shop” në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe së fundmi që prej 2009 marrja e licensave në Qendrën Kombëtare të Liçensimit (QKL). Gjithashtu po zbatohet një projekt për të ngritur pika aksesit për publikun në të gjitha Zyrat e Postës Shqiptare.

Në katër vitet e fundit shkollat publike janë të pajisur me laboratorë kompjuterikë, të lidhur me Internet broadband. Janë hartuar e përshtatur kurrikulat për TIK mbi standardet e Bashkimit Evropian si dhe është mundësuar akses interneti me shpejtësi të lartë. Qeveria është e vendosur të kalojë në fazën e përdorimit masiv të teknologjisë së informacionit nga të gjithë institucionet shtetërore të të gjitha niveleve, qoftë lidhur



## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

me proceset e brendshme vendimmarrëse e operative, ashtu edhe në shërbimet e drejtpërdrejta për qytetarët dhe subjektet.

Qeveria shqiptare inicioi programin “Shqipëria dixhitale” si pjesë e programit të saj për periudhën 2009-2013. Ky program në thelb të saj nuk ka të bëjë me përdorimin e kompjuterit, bazën e të dhënave apo ndërfaqet e internetit, por mbi të gjitha lidhet me përdorimin e tyre për të nxitur një qeverisje efektive dhe demokratike, përmirësimin e sistemit arsimor, informacionit dhe shërbimeve që Qeveria ju ofron qytetarëve të saj.

Zbatimi i kësaj faze, kombinuar me investimet masive të teknologjisë së informacionit të sistemin arsimor e bëjnë shtetin nxitësin kryesor të rritjes së shkallës së përdorimit të këtij instrumenti nga e gjithë shoqëria dhe tregu dhe e kalojnë Shqipërinë shumë shpejt në bashkësinë e vendeve me shkallë të lartë të modernizimit dhe dixhitalizimit të përdorimit të kësaj teknologjie. Por përsëri normat e përdorimit të TIK dhe broadband (lidhja në band të gjerë) jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Ballkan janë më të ulëta se mesatarja e BE-së.

Strategjia jonë për zhvillimin e TIK është lidhja në band të gjerë e shërbimeve të administratës publike. Kjo do të ulë kostot për biznesin dhe qeverinë, detyrimet e taksave dhe do të nxisë konkurrencën.

Zhvillimet e shpejta të teknologjisë së informacionit si dhe shtrirja e përdorimit të saj, pothuajse në të gjitha fushat e veprimtarisë së shoqërisë, bëjnë evidente kërkesat për shërbime të sigurta dhe të besueshme.

Spektori publik bëhet kështu më transparent dhe i hapur, forcohet demokracia, rritet si përgjegjshmëria ndaj qytetarëve ashtu dhe

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

pjesëmarrja e tyre në procesin e politikëbërjes, administrata orientohet duke vënë në qendër qytetarin, duke siguruar shërbime online 24 orë ditë, 7 ditë të javës.

Në këtë kuadër, jam i kënaqur që kjo revistë i kushtohet qeverisjes elektronike, si një ndër synimet kryesore të qeverisë shqiptare. Në funksion të këtij qëllimi, institucionet shtetërore, ndër to edhe Departamenti i Administratës Publike, i kanë dhënë vetes një mision të rëndësishëm- vënien në shërbim të qytetarit!

Faleminderit,

**Genc Pollo**

Ministër për Inovacionet dhe  
Teknologji e Informacionit dhe Komunikacionit,  
Shqipëri

## **Shqipëria merr çmimin e dytë për vlerësimin e ekselencës në shërbimin publik**

Shqipëria vlerësohet si vendi i parë në botë që ka zhvilluar sistemin e prokurimit elektronik të detyrueshëm 100% për të gjitha prokurimet publike mbi pragun e 3000 euro. Agjencia Shqiptare e Prokurimit Publik mori çmimin e vendit të dytë për Shërbimin Publik për Evropën dhe Amerikën e Veriut, për zhvillimin e një platforme prokurimi elektronik, të mundësuar nga Programi i Pragut të Mijëvjeçarit, administruar nga USAID.

Platforma elektronike e prokurimit është një aplikim i bazuar në rrjet që mundëson transaksione të sigurta midis institucioneve publike shqiptare dhe komuniteteve kombëtare dhe ndërkombëtare të biznesit. Kjo platformë ofron një përgatitje dhe administrim të sigurt, eficient dhe transparent të të gjitha dokumentave të lidhura me tenderat, shmangien e dokumentacionit të panevojshëm, si dhe sigurimin e fluksit të të dhënave gjatë gjithë procesit. Ulja e kostos administrative me 15%, përmes këtij sistemi, ka rritur konkurrueshmërinë dhe ka futur konceptin e transparencës, duke bërë që Shqipëria të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e Bashkimit Europian për prokurimin Elektronik.

Kombet e Bashkuara akorduan 23 çmime për institucionet publike nga e gjithë bota, duke njohur përmirësimin e tyre në shërbimin publik, si dhe arritjet e tyre në zhvillimin e administratave më efektive dhe më të përgjegjshme publike. Vendet fituese ishin nga Shqipëria, Australia, Bahreini, Brazili, Kanadaja, Gjermania, Japonia, India, Italia, Republika e Koresë, Liban, Oman, Arabia Saudite, Tanzani dhe Tunizia. Këto vende u dalluan nga risitë në përmirësimin e cilësisë, transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë në shërbimin publik, si dhe për avancimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin e politikave vendimmarrëse.

Çmimi i OKB-së për shërbimet publike jepet që prej vitit 2003, kur Asambleja e Përgjithshme caktoi 23 qershorin si ditën e Shërbimit Publik.

# UN rank Albania at the II<sup>nd</sup> place in the world for the electronic Procurement

Office of the Director  
 Division for Public Administration and Development Management  
 Department of Economic and Social Affairs  
 Two United Nations Plaza, Room 1714, New York, NY 10017  
 Tel.: 1 (212) 963.5761 • Fax: 1 (212) 963.9681 • Email: unpan@un.org

DPADM/10/972

7 May 2010

Dear Ms. Cankja,

I am pleased to congratulate your organization on winning the 2010 United Nations Public Service Award in the category of "Improving transparency, accountability and responsiveness in the Public Service" for the "Public Procurement Agency", as a second-place winner. Your institution's outstanding achievement has demonstrated excellence in serving the public interest and I am sure it has made a significant contribution to the improvement of public administration in your country. It will be an inspiration and encouragement for others working for the public service.

Yours sincerely,



Haiyan Qian  
 Director



### 3. Shqipëria Digitale

*Qeveria shqiptare inicioi programin “Shqipëria dixhitale” si pjesë e programit të saj për periudhën 2009-2013. Ky program në thelb të saj nuk ka të bëjë me përdorimin e kompjuterit, bazën e të dhënave apo ndërfaqet e internetit, por mbi të gjitha lidhet me përdorimin e tyre për të nxitur një qeverisje efektive dhe demokratike, përmirësimin e sistemit arsimor, informacionit dhe shërbimeve që Qeveria u ofron qytetarëve të saj.*

Douglas Engelbart, shpikësi i miut të kompjuterit thoshte se “Revolucioni dixhital është shumë më i rëndësishëm se shpikja e të shkruarit...”. Kjo shprehje që në fillim dukej si një ekzagjerim i këndshëm, është sot një realitet evident në çdo fushë të jetës.

Në të vërtetë revolucioni dixhital, është zhvilluar me një ritëm që nuk mund të krahasohet me asgjë tjetër dhe, ky zhvillim ka pasur një ndikim vendimtar në shoqërinë njerëzore dhe në jetët tona.

Të jesh pjesë e këtij revolucioni, ta ndjekësh atë me ritmin e vet, është thelbësore për zhvillimin. Është për këtë arsye që Qeveria Shqiptare dhe veçanërisht Kryeministri i saj Zoti Sali Berisha, e ka vendosur nismën “Shqipëria Digitale” si prioritet të madh të saj.

Në kushtet shqiptare, kjo nismë është një ndërmarrje gjigande që kërkon përpjekje titanike, për t’ja dalë mbanë me ritmin e duhur. Vështirësitë kanë qenë dhe janë të mëdha, pasi një përpjekje e tillë kërkon veçanërisht shumë energji, kohë dhe para. Ajo ka kërkuar dhe vazhdon një investim madhor në burimet njerëzore, në pershtatjen e kuadrit përkatës ligjor, në planifikimin dhe ngritjen e strukturave adekuate institucionale, investime direkte në teknologji, etj.

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

Pikërisht në kuadër të kësaj nisme, Shqipëria ka arritur rekorde në vendosjen e sistemeve elektronike, dhe sistemi i teknologjisë dhe informacionit ka penetruar me shpejtësi në administratën publike dhe në arsim.

Natyrisht Shqipëria vazhdon në mjaft raste që të ketë mangësi në komunikimin mes politikës, biznesit, arsimit dhe prodhuesve të teknologjisë. Kjo vjen pjesërisht për shkak të roleve tradicionale të grupeve të ndryshme të interesit, por edhe për shkak të faktit se Shqipëria nuk ka trashëguar ndonjë traditë, jo vetëm të teknologjive, por edhe ndikimin e mundshëm të teknologjisë në zhvillimin organizativ dhe të gjitha industritë kryesore.

Megjithatë, vitet e fundit është bërë një progres i ndjeshëm, në drejtim të qeverisjes elektronike; lehtësimit të biznesit përmes kryerjes së shërbimeve on-line; reformave të ndërmarra në kuadër të përmirësimit të regjimit rregullator, si regjistrimi i biznesit përmes ngritjes së Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit; në drejtim të edukimit përmes krijimit të kabineteve të informatikës nëpër shkolla; informatizimit të shërbimeve në dogana e tatime. Po kështu është rritur edhe ndërgjegjësimi për përfitimet nga teknologjia e informacionit dhe shkalla e përdorimit të internetit nga bizneset dhe qytetarët sidomos për brezin e ri.

Ishte pikërisht kështu që në Barcelonë Shqipërisë, iu akordua, “Public Service Award”, një çmim për Shërbimin Publik të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

## Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I

*Disa arritje të Qeverisjes Elektronike, do të veçonim:*

- *Aplikimi i prokurimit elektronik dhe ngritja e institucionit të avokatit të prokurimeve. Sot, në Shqipëri, të gjitha prokurimet publike bëhen në mënyrë elektronike dhe sipas rregullave dhe përvojës më të mirë evropiane e ndërkombëtare.*

- *Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ofron shërbimin për deklarimin e tatimeve online dhe për kompanitë e mëdha siguron edhe kryerjen e pagesave “on-line”.*

- *Në sistemin doganor përmes sistemit automatik të përpunimit të të dhënave gjatë procesit të zhdoganimit është bërë e mundur përpunimi në kohë reale i deklaratave doganore, zhdoganimi më i shpejtë i ngarkesave, si dhe është përmirësuar kontrolli mbi të ardhurat duke siguruar dhe një informacion më të saktë dhe të azhornuar për tregtinë e mallrave.*

- *Amendimi i ligjit 9918 datë 19.5.2008 për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë (EU directives). Miratimi i këtij dokumenti të politikave për komunikimet elektronike paraqet vizionin e qeverisë për zhvillimin e sektorit të TIK në kontekst të planeve kombëtare në përputhje me traktatin dhe marrëdhëniet politike të Shqipërisë me BE-në*

Po kjo nuk është e gjitha, pasi reformat po vazhdojnë me ritëm të lartë. Kështu, bazuar në orientimet dhe deklaratimet publike të Kryeministrit Berisha për prioritetin e lartë të zhvillimit të Shoqërisë së Informacionit, në kuadër të programit të qeverisë, me synim përshpejtimin e zbatimit të programit “Shqipëria Dixhitale”, u krijua në 2009 një strukturë e posaçme pranë Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit. Qëllimi është të sigurojë një udhëheqje strategjike dhe teknike, koordinimin e përgjithshëm, mbështetjen dhe mbrojtjen për të gjitha çështjet e politikave, ligjeve, rregulloreve dhe strategjive për sektorin e TIK dhe telekomunikacionit.

Shqipëria dixhitale do të kontribuojë përmes një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit që të gjithë qytetarët të përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike.

*Disa nga prioritetet e “Shqipëria dixhitale”:*

***1. Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit***

*Synimi që administrata qendrore dhe vendore në të gjithë Shqipërinë, si dhe qytetarët dhe bizneset të kenë mundësinë e përdorimit të shërbimeve të rrjetit të shpejtësisë së lartë dhe për të ofruar këtë shërbim do të garantohet dhe do të nxitet konkurrenca midis operatorëve për të mundësuar çmime të arsyeshme dhe të krahasueshme me vendet e rajonit.*



## **2. Zhvillimi i qeverisjes elektronike**

*Qeverisja elektronike do të shtrihet në nivelin qendror dhe atë lokal nëpërmjet portaleve të të gjitha institucioneve, gjë që do të sigurojë akses elektronik në shërbimet publike dhe do ta bëjë ato interaktive, të thjeshtë dhe të aksesueshme për të gjithë.*

## **3. Edukimi dhe përhapja e njohurive**

*Qeveria do të investojë në burimet njerëzore dhe në aftesitëe tyre për të pasur një rini në botën dixhitale*

## **4. Nxitja e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit nga biznesi.**

*Do të stimulohet përdorimi i internetit përmes krijimit të kuadrit të nevojshëm ligjor për biznesin elektronik dhe edukimit të biznesit për përfitimet dhe mundësitë e ofruara nga teknologjia e informacionit dhe komunikimit.*

## **5. Përmirësimi i legjislacionit për shoqërinë e informacionit.**

*Struktura përgjegjëse do të punojë për plotësimin dhe përmirësimin e legjislacionit përkatës për shoqërinë e Teknologjive të Informacionit e Komunikimit dhe shërbimeve postare.*

Siç mund të kuptohet lehtë nga gjithë sa u tha më lart “Shqipëria Dixhitale” është mirëfilli një revolucion, dhe si i tillë ai është i gjithkrahshëm. Në këtë sens ai është edhe botëkuptimor, që do të thotë që ai do të përballet jo vetëm me vështirësi të të kuptuarit dhe të të pranuarit, por do të hasë edhe problematika që do të kenë të bëjnë me identifikimin e koncepteve të reja dhe aplikimin e tyre sipas një plani

vizionar. Duke e kuptuar drejt rëndësinë dhe vështirësinë e këtij misioni, me vetë inisiativën e Kryeministrit të vendit, është krijuar Departamenti i Shqipërisë Dixhitale (DEDAL), pjesë e të cilit është edhe Drejtoria e promovimit të brandit “Shqipëria Dixhitale”.

Në fokus të punës së DEDAL do të jetë përpunimi i inisiativave në hartimin e politikave dhe akteve ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me shoqërinë dixhitale , gjithashtu edhe koordinimi i projekteve dhe programeve midis ministrive, agjencive publike dhe bashkëpunimi me sektorin privat dhe donatorët e huaj. DEDAL do të shërbejë si urëlidhëse me organizatat ndërkombëtare duke e përfaqësuar vendin tonë në konventat, organizatat ndërkombëtare dhe aktivitetet më të rëndësishme në fushën e komunikimeve elektronike dhe shoqërisë së informacionit.

*Siç u theksua edhe më lart, ky revolucion është njëherazi edhe botëkuptimor, dhe si i tillë e bën të detyrueshme që inisiativa promovuese të plotësojë më se paku këto kritere:*

- *Të jetë lehtësisht e asimilueshme me mesazhe të thjeshta e gjuhë miqësore. Instrumentat e saj duhet të jenë atraktive dhe të personalizuar në varësi të targetit të përzgjedhur.*
- *Të jetë e gjerë, veprimet dhe instrumentat e saj t’u adresohen të gjitha implikimeve (sociale, ekonomike, kulturore) të identifikuara apo që do të shfaqen në vijim gjatë aplikimit të nismës Shqipëria Dixhitale.*
- *Të jetë e fokusuar mirë, dhe kjo nuk është aspak një kundërthënie apo ndonjë kundërshti konceptuale me shumëkahshmërinë e fushatës. Në të vërtetë kjo nënkupton se pavarësisht gjerësisë së saj, inisiativa promovuese nuk do t’i trajtojë të gjitha fenomenet apo synimet e saj njëherazi, por hap pas hapi. Me fjalë të tjera ajo do t’i përcaktojë mirë*

## Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I

*dhe në kohë prioritetet e saj dhe do të përqendrohet intensivisht në realizimin e tyre në afatet e parashikuara.*

- *Të jetë gjithëpërfshirëse, që do të thotë të përfshijë aktivisht të gjitha grupet e interesit, institucionet e linjës, organizatat qeveritare ose joqeveritare, publike apo private, kombëtare dhe ndërkombëtare, grupet komunitare, lider të komunitetit apo individë e saj të shquar.*

- *Të jetë e thellë dhe të adresojë në mënyrë të plotë e të gjithëanshme çdo implikim social, ekonomik, kulturor, etj., të nismës “Shqipëria Dixhitale”.*

- *Të jetë e aftë të vetëanalizohet dhe vetëpërmirësohet, dhe, për çdo fazë të saj të mund të identifikojë indikatorët përkatës të suksesit, instrumentat e përshtatshëm për mbajtjen e impaktit, si dhe masat efikase për të korrigjuar defektet e zbuluara.*

E gjitha kjo është sa intriguese aq edhe emocionuese e motivuese. Përpara kemi një rrugë të vështirë, plot me të papritura e pengesa të njohura për t’u kapërcyer. Por, njëkohësisht jemi aktorë të një transformimi emocionues, të një shndërrimi rrënjësor që do të lerë gjurmë në jetët tona, ndaj jemi entuziast në rrugën që kemi marrë.

**Majlinda Myrto**

Drejtoreshë

Departamenti i Promovimit të Shqipërisë Dixhitale

**Sidrit Malevi**

Drejtor

Departamenti i Shqipërisë Dixhitale

## Roli i Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHi) në zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHi) është krijuar në shtator të vitit 2007, nën varësinë e Këshillit të Ministrave, Tiranë. Objektivi i përgjithshëm i saj është koordinimi i të gjitha aktiviteteve të Qeverisë Shqiptare në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.*

Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit (TIK) luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen e qëllimit strategjik për një qeverisje gjithmonë edhe më të mirë. Nëpërmjet TIK sigurohet qeverisja elektronike (*e-qeverisja*), e cila nuk është gjë tjetër, por një instrument për një qeverisje më efektive, më efçente dhe më transparente. Sot, dobia kryesore e sistemeve teknologjike të qeverisjes elektronike shihet në ndërtimin e një shoqërie informacioni të hapur nëpërmjet ofrimit të një morie të gjerë të shërbimeve publike on-line, duke nxitur partneritete të ndërsjella publike dhe private me përfitime të qarta ekonomike, në rritjen e demokracisë përfaqësuese duke tejkaluar nivelet e ulëta të pjesëmarrjes elektorale, dhe veçanërisht në praktikat dhe modelet qeverisëse aktuale, të cilat po ndryshojnë rrënjësisht.

*e-Qeverisja* është një instrument i një shoqërie informacioni në formën e parimeve qeverisëse, strategjive, sistemeve dhe mjeteve që mundësojnë përdorimin e TIK në ndërveprimet reciproke ndërmjet elementëve kyç të shoqërisë – shteti, qytetarët, dhe bizneset – për të forcuar demokracinë dhe mbështetur zhvillimin. *e-Qeverisja* nuk është

thjeshtë një çështje e pajisjes me kompjuter të nëpunësve të administratës shtetërore apo automatizimi i praktikave të punës. Fokusimi vetëm në zgjidhje teknologjike nuk do të ndryshojë mentalitetin e burokratëve që nuk e shohin qytetarin as si një klient të qeverisë, as si një pjesëmarrës në vendim-marrje. *e-Qeverisja* përdor teknologjinë për kryerjen e reformave duke kultivuar transparencë, eliminuar distancën dhe ndarjet e tjera, dhe duke u mundësuar qytetarëve që të jenë pjesëmarrës në proceset politike që ndikojnë në jetën e tyre.

**Endri Hasa**

Drejtor

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

## **Strategjia për shoqërinë e informacionit, një strategji mbi parimin e gjithëpërfshirjes**

Modeli i sotëm i zhvillimit të e-qeverisjes përfshin jo vetëm përdorimin e teknologjisë së informacionit për të automatizuar proceset e brendshme të punës së qeverisë, por edhe përdorimin e kësaj teknologjie për të mbështetur dhe transformuar punën e jashtme të qeverisë. Ky model mundëson vendosjen e sistemeve të informacionit në zemër të reformës. Duke zgjeruar fokusin nga thjeshtë e-administrate, duke përfshirë në to edhe e-shtetasin, e-shërbimet dhe e-shoqërinë. Përfundimisht sot e-qeverisja është përdorimi i TIK për të arritur qeverisje më të mirë, duke integruar teknologjitë e përpunimit dhe komunikimit të informacionit, integritit të plotë shtetas, procese, informacion dhe teknologji për të arritur objektivat e qeverisjes së mirë.

## Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I

Pikërisht në këtë frymë është hartuar Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit, miratuar me VKM nr. 59, datë 21.1.2009 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit”, e cila përcakton si vizion të zhvillimit:

*“Progresin e Shqipërisë drejt një ekonomie të bazuar në njohuritë, përmes një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit që do të çojë në një shoqëri ku të gjithë qytetarët përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike.”*

## Ofruesit e shërbimit të qeverisjes elektronike

### Ofrimi i shërbimeve në nivel qendror

- Ministritë e linjës
- Institucionet e varësisë
- Ndërmjetësit e ofrimit të shërbimit

### Ofrimi i shërbimeve në nivel lokal

- Autoritetet Lokale
- Bashki/Komuna

- [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)
- [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)
- [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)
- [www.qkl.gov.al](http://www.qkl.gov.al)
- [www.dogana.gov.al](http://www.dogana.gov.al)
- [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)
- [www.moe.gov.al](http://www.moe.gov.al)
- <http://www.mpcs.gov.al/institucionet-e-varesisë/22-sherbimi-kombetar-i-punesimit->
- [http://www.issh.gov.al/index.php?option=com\\_content&task=category&sectionid=3&id=8&Itemid=43](http://www.issh.gov.al/index.php?option=com_content&task=category&sectionid=3&id=8&Itemid=43)
- [http://www.dpshttr.gov.al/html/sherbime\\_regjistrimi.htm](http://www.dpshttr.gov.al/html/sherbime_regjistrimi.htm)
- <http://www.asp.gov.al/>
- [http://www.bksh.al/Katalogu/library/wwwwopa.c/wwwroot/beginner/index\\_al.html](http://www.bksh.al/Katalogu/library/wwwwopa.c/wwwroot/beginner/index_al.html)
- [www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)
- <http://www.qsu.gov.al/>
- [www.qpz.gov.al/](http://www.qpz.gov.al/)
- .....

## Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I

Shqipëria e vendosur në rrugën e saj për anëtarësim në Bashkimin Europian ka ndërmarrë një sërë reformash të nevojshme për t'u afruar sa më shumë me standardet ndërkombëtare dhe europiane. Modeli europian i zhvillimit është modeli i një ekonomie të bazuar në njohuritë dhe në shoqërinë e informacionit.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim është dokumenti i rëndësishëm strategjik që përcakton objektivat dhe vizionin e Shqipërisë në rrugën drejt integritit dhe prosperitetit ekonomik.

Zhvillimi i shoqërisë së informacionit është një nga prioritetet e qeverisë shqiptare e materializuar në Strategjinë ndërsektoriale për shoqërinë e informacionit dhe në programin e saj për periudhën 2009-2013, përmes iniciativës “Shqipëria Dixhitale”.


Strategjia ndërsektoriale për shoqërinë e informacionit u miratua nga Këshilli i Ministrave me VKM nr. 59 dt. 21.1.2009 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit”, pas një procesi të gjerë konsultimi me grupet e interesit.

Kjo strategji është hartuar në përputhje me objektivat dhe qëllimet e SKZHI (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim) dhe në përmbushje të angazhimeve të marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, në nenin 70, dhe 103 të saj.

Kjo strategji përcakton si vizion:

*“Progresi i Shqipërisë drejt një ekonomie të bazuar në njohuritë përmes një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit që do të çojë në një shoqëri ku të gjithë qytetarët të përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike”.*

## Hapat drejt zhvillimit të shoqërisë së informacionit ....





## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

Në strategji janë përcaktuar fushat prioritare bashkë me objektivat e përgjithshëm që synohen të arrihen, si infrastruktura, qeverisja elektronike dhe shërbimet publike, edukimi dhe njohuritë, e-biznesi dhe hartimi i kuadrit përkatës ligjor në përputhje me standardet europiane.

Kjo strategji është e shoqëruar dhe me një plan veprimi ku përcaktohen aktivitetet dhe institucionet përgjegjëse për përmbushjen e tyre.

Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit, 2008-2013 mbështetet në modelet dhe praktikat më të mira europiane, përsa i përket objektivave dhe zgjidhjeve të parashikuara, duke marrë në konsideratë karakteristikat specifike të shoqërisë dhe ekonomisë shqiptare.


Politikat e përcaktuara në këtë dokument janë të ngjashme me përcaktimet në dokumentin “Europe Action Plan” dhe “Iniciativën E-2010”.

Strategjia për shoqërinë e informacionit është e ndërtuar në katër kapituj:

- Gjendja aktuale;
- Vizioni, përparësitë dhe qëllimet strategjike;
- Politikat;
- Burimet e financimit, vlerësimi dhe monitorimi.

Në kapitullin e parë bëhet një analizë e gjendjes nga niset strategjia dhe sipas drejtimeve dhe fushave prioritare të përcaktuara.

Me analizën e situatës në fazën e përgatitjes së strategjisë janë identifikuar dhe problematika sipas drejtimeve kryesore.



Qëllimet strategjike të përcaktuara në kapitullin e dyte përfshijnë:

(i) zhvillimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duke synuar që deri më 2013 e gjithë administrata në nivel qendror dhe vendor të jetë e lidhur me rrjet të shpejtësisë së lartë (broadband);

(ii) krijimin e mundësisë për internet të lirë, të shpejtë dhe të sigurtë duke nxitur konkurrencën dhe zhvillimin e një kuadri rregullator efektiv;

(iii) zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe të shërbimeve publike, duke synuar kalimin nga faza e parë e shpërndarjes së informacionit në rrugë elektronike, në fazën e avancuar të ofrimit të shërbimeve publike elektronike interaktive;

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

(iv) ofrimin e shërbimeve publike bazë në mënyrë elektronike, interaktive dhe të aksesueshme për të gjithë, deri në fund të vitit 2013.

(v) edukimin dhe përhapjen e njohurive, përmes investimit në burimet njerëzore, sigurimit të lidhjes së shkollave me rrjet të shpejtësisë së lartë;

(vi) zhvillimi i “e-biznesit” dhe


(vii) plotësimi dhe përmirësimi i legjislacionit për shoqërinë e informacionit.

Politikat që do të ndiqen për përmbushjen e objektivave dhe realizimin e vizionit për një shoqëri të bazuar në njohuritë përshkruhen në kapitullin e katërt të strategjisë.

Në fushën e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit zhvillimi i rrjeteve broadband është një nga drejtimit kryesore, krijimi i pikave të aksesit publik, krijimi i një kuadri rregullator efektiv etj. janë politikat e përcaktuara në këtë drejtim.

Në politikat për një qeverisje më të mirë përmes shërbimeve online moderne, jepen drejtimit ku do të punohet për realizimin e qeverisjes elektronike si implementimi i projektit e-kabinet; sistemi i menaxhimit të dokumentacionit; krijimi i arkivave elektronike; krijimi i kuadrit të duhur ligjor dhe rregullator; sigurimin e shërbimeve të reja me kosto më të ulët që stimulojnë progresin ekonomik e shoqëror.


Në fushën e edukimit zhvillimi i shoqërisë së informacionit shihet jo vetëm në aspektin e edukimit në shkolla, por dhe edukimi i publikut apo shpërndarja e njohurive në tërësi sikurse jepet dhe në diagramën e mëposhtme.



Politikat në fushën e kërkimit shkencor për TIK, të punësimit, të shëndetësisë etj. zenë gjithashtu një vend të rëndësishëm në këtë kapitullin e tretë të strategjisë.

Shoqëria e informacioni është relativisht një koncept i ri jo vetëm për vendin tonë. Për më tepër shoqëria e informacioni lidhet me TIK (teknologjinë e informacionit dhe komunikimit) që karakterizohet nga ndryshime të vullshme. Si pasojë dhe legjislacioni për shoqërinë e informacionit, duhet të plotësohet dhe përmirësohet dhe do të mbetet në vëmendje të vazhdueshme, për të siguruar një kuadër ligjor efektiv për zhvillimin e shoqërisë së informacionit. Në vijimësi do të punohet për përshtatjen e legjislacionit vendas me “*acquis communautaire*” të BE.

Niveli i sofistikimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike  
G2B




Situata e niveleve te ofrimit te sherbimeve elektronike per qytetarin dhe biznesin.

## Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I

Hartimi i politikave, vendosja e objektivave dhe përcaktimi i një vizioni ambicioz nuk do të vlente pa parashikuar mekanizmat e implementimit dhe monitorimit të tyre.

Le të kthehemi tek Strategjia e Shoqërisë së Informacionit, një strategji mbi parimin e gjithëpërfshirjes.

Shoqëria e informacionit është e gjerë, ajo prek të gjithë sektorët e ekonomisë, pasi nuk është gjë tjetër veçse vete ekonomia që përfiton nga përdorimi i teknologjisë së informacionit.



## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

Duke qenë një strategji ndërsektoriale, por me ndërthurje jo vetëm të sektorit publik dhe atij privat, kjo strategji kërkon koordinim dhe bashkërendim të iniciativave dhe aktiviteteve nga institucione të ndryshme me qëllim maksimalizimin e përfitimeve nga përdorimi i TIK.

Buxhetimi dhe financimi i vazhdueshëm adekuat është një nga çështjet kritike për të bërë të mundur implementimin e strategjisë. Në strategji është theksuar se nga secila ministri, apo institucion buxhetor përgjegjës, do të bëhet specifikimi i produkteve, aktiviteteve dhe kostove për llogari të projekteve të TIK, gjatë procesit të planifikimit buxhetor afatmesëm PBA.

Kapitulli i katërt: monitorimi dhe vlerësimi.

Në këtë kapitull jepen treguesit që do të jenë në vëmendje për vlerësimin e zbatimit të strategjisë dhe zhvillimit të shoqërisë së informacionit. Duhet theksuar se një pjesë e treguesve mund të merren mbi bazën e anketimit dhe në këtë drejtim del e domosdoshme kontributi i INSTAT kryesisht, si edhe bashkëpunimi me institucione të tjera përgjegjëse për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore.


Procesi i implementimit të strategjisë realizohet në nivel kombëtar dhe lokal. Në nivel kombëtar procesi ndiqet nga një grup ndërinstitutional dhe udhëhiqet nga Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit.

Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit si institucion luan rol të rëndësishëm në koordinimin e aktiviteteve për zhvillimin e shoqërisë së informacionit, zbatimin dhe monitorimin e strategjisë.

Implementimi i strategjisë kërkon domosdoshmërisht kontributin e të gjithë aktorëve dhe koordinimin e harmonizimin e përpjekjeve të përbashkëta.

## Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I

Ju mund ta lexoni të plotë Dokumentin e Strategjisë Ndërsektoriale të Shoqërisë së Informacionit: [www.akshi.gov.al](http://www.akshi.gov.al)



Portali: [www.e-Albania.al](http://www.e-Albania.al), krijuar në fillim të vitit 2010, një mundësi për të marrë shërbimet elektronike në parimin “one stop shop” ose “single window”.



## **Risitë në fushën e Prokurimeve Publike - Platforma elektronike**

*Agjencia e Prokurimit Publik (APP) është organ qendror, person juridik civil në varësi të Kryeministrit, që financohet nga buxheti i shtetit. Në përputhje me legjislacionin e prokurimeve, Agjencia është organi më i lartë në fushën e prokurimeve dhe vendimet apo udhëzimet e saj janë përfundimtare administrativisht. Nëpunësit e Agjencisë së Prokurimit Publik gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërsa personeli tjetër, emërohet nga Drejtori i Agjencisë dhe statusi i tyre rregullohet me Kodin e Punës.*

### **Sistemi i Prokurimit Elektronik, nga sfida tek sukcesi**

Aplikimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik ishte një sfidë dhe një arritje e madhe në të njëjtën kohë, për sistemin e prokurimit publik shqiptar.

Platforma e Prokurimit Elektronik (APP) është një aplikim i bazuar në rrjet, i cili mbështet automatizimin e punës të të gjitha autoriteteve kontraktore shqiptare. Ky sistem bën të mundur transaksione të sigurta ndërmjet institucioneve publike shqiptare dhe komunitetit të biznesit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Sistemi i prokurimit elektronik ofron siguri, efikasitet dhe transparencë lidhur me përgatitjen dhe administrimin e dokumentave të tenderit, duke bërë të mundur heqjen e dokumentave voluminoze shkresore,

duke mundësuar rrjedhën e sigurt të të dhënave në të gjithë procesin. Të gjitha dokumentat e tenderit nga njoftimi i kontratës, në njoftimin e fituesit dhe më tej në njoftimin e kontratës së nënshkruar mund të gjenden lehtësisht në sistemin e prokurimit elektronik (në faqen zyrtare <https://www.app.gov.al>), dhe të gjitha transaksionet, duke filluar nga shkarkimi i dokumentave të tenderit deri në dhënien e ofertës nëpërmjet mjeteve elektronike, mund të kryhet në çdo kohë dhe nga çdo vend ku mund të ndodhen operatorët ekonomikë shqiptarë apo të huaj, dhe të gjitha këto transaksione janë pa pagesë.

Sistemi i prokurimit elektronik publik redukton kohën e aplikimeve, eliminon dokumentat e panevojshme, lehtëson dhe standardizon procesin e njohjes me kushtet e tenderit. Po kështu, ai garanton fshehtësinë e ofertës, dhe deri në kohën e hapjes së procedurave lejon hedhjen e njëkohshme të shumë ofertave. Për më tepër, sistemi elektronik gjeneron raporte për një inspektim të mëvonshëm duke mundësuar kontrollin dhe zvogëlimin e devijimeve korruptive.

Sistemi siguron një pjesëmarrje më të madhe të operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, pasi ata mund të paraqesin ofertat e tyre në mënyrë elektronike, nga vendi i tyre i punës, si dhe mund të marrin informacion për procedurën e prokurimit që kanë aplikuar në kohë të caktuar, pa qenë e nevojshme për të qenë të pranishëm në Autoritetin Kontraktues. Pra, konkurrenca është më e madhe, dhe si pasojë mund të sigurohen mallra dhe shërbime me cilësi të mirë dhe me një çmim më të ulët.

Operatorët ekonomikë shqiptarë, të cilët janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve, mund të aplikojnë për t'u regjistruar në sistemin e prokurimit elektronik. Pasi të jenë të regjistruar, ata do të kenë gjithmonë mundësinë për të marrë pjesë në procedurat e

prokurimit publik dhe të paraqesin ofertat e tyre në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj gjithashtu duhet të jenë regjistruar dhe të pajisen me një emër përdoruesi dhe fjalëkalim, për të hyrë në sistemin e prokurimit elektronik. Kjo mund të realizohet nëpërmjet regjistrimit (on-line) si operator ekonomik, apo në zyrat e agjencisë së Prokurimit Publik. Regjistrimi mund të bëhet vetëm një herë dhe është i vlefshëm për të ofertuar në të gjitha procedurat e prokurimit publik në Shqipëri, në çdo kohë.

Përfitimet e përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik janë gjithashtu të matshme në terma konkrete, për shembull, përqindja e fondit limit të kursyer në procedurat elektronike është 15% dhe numri i ofertuesve nga procedurat me shkresa në procedurat elektronike është rritur nga 2,3 në 7,7 ofertues. Këto janë tregues të qartë të nivelit të lartë të komunikimit dhe transparencës së këtij sistemi dhe na lejojnë të themi se sfida e madhe, me të cilën u ballafaquam në fillim të aplikimit të sistemit të prokurimit elektronik, tani është shndërruar në një sukses për sistemin e prokurimit publik në Shqipëri.

Përsëndetje

**Klodiana Cankja**

Drejtoreshë

Agjencia e Prokurimeve Publike

## **Trainimet e ofruara në bashkëpunimin me Institutin e Trajnimit të Administratës Publike (ITAP)**

*ITAP është një institucion shtetëror, në varësi të DAP, i krijuar në qershor 2000, në kuadër të reformave të ndermarra për përmirësime dhe zhvillime në administratën publike dhe shërbimin civil shqiptar, me qëllim që ato të jenë sa më të qendrushëm, profesionale dhe eficiente. Veprimtaria trajnuese që organizon dhe ofron Instituti synon që të rrisë aftësitë profesionale dhe të përmirësojë njohuritë bazë të nëpunësve civilë, në mënyrë që secili prej tyre, në pozicionin përkatës të përmbushë sa më mirë qëllimet e tij dhe të institucionit.*

Në përgjigje të kërkesës së Qeverisë Shqiptare për trajnimin e nëpunësve e pushtetit vendor të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik në të gjithë Shqipërinë, me qëllim rritjen e kapaciteteve të këtyre nëpunësve për kryerjen e procedurave të prokurimit publik me mjete elektronike, Departamenti i Administratës Publike (DAP) dhe Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (ITAP), më datë 10 tetor 2008, me praninë e **Sh. T. Z. Sali Berisha - Kryeministër i Shqipërisë**, shpalli fillimin e një programi trajnimi në lidhje me Prokurimet Elektronike. Sipas Fatmir Demnerit, drejtor i ITAP ky program trajnimi synoi të njohë Administratën Publike në nivel lokal dhe qendror me konceptet e reja të kryerjes së procedurave të prokurimit publik në formë elektronike, duke u njohur me platformën ligjore dhe teknike të prokurimit publik.

Përfitues të drejtëperdrejtë të këtij trajnimi ishin Autoritetet Kontraktore të pushtetit lokal (bashkitë dhe komunat), Shërbimi civil, APP dhe Instituti i Trajnimit të Administratës Publike. Sipas tij, Kurrikula e këtij trajnimi u hartua nga ekspertë të prokurimit publik, që njëkohësisht janë aktivizuar edhe si trajnerë në to. Trajnimi u zhvillua

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

në të gjithë qarqet e Shqipërisë, gjatë vitit 2008 dhe në Ministrinë e Linjës e Institucionet e tjera të varësisë së tyre, gjatë vitit 2009.

Gjatë vitit 2008, u zhvilluan 24 kurse dhe janë trajnuar 984 nëpunës civilë në nivel lokal, ndërsa për vitin 2009, numri i kurseve të zhvilluar ishte 31 dhe nëpunës civilë të trajnuar 991 veta.

### *Çështje të Kurrikulës*

*Paraqitja e ligjit të prokurimit publik, Shpjegimi i Terminologjisë së LPP. Parimet e prokurimit publik, Ndryshimet e legjislacionit.*

- *Procedurat e prokurimit publik. Përzgjedhja e procedurës së saktë dhe justifikimi i përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.*
- *Mekanizmi i korigjimit. Procesi i ankimit. Avokati i prokurimeve. Buletini i prokurimit publik. Afatet kohore të prokurimit.*
- *Paraqitja e faqes së internetit të APP-së. Përdorimi i saj. Dokumentet standarde. Kërkesat e reja të ligjit në lidhje me publikimin në internet dhe materialet që gjenden në të. Prokurimi Elektronik, paraqitja e platformës ligjore*

## **Rëndësia e trajnimeve për Prokurimin Publik**

**Reida Kashta (Shahollari)**  
**Përgjegjëse e Njesisë së Trajnimit**  
**APP**

**Ju jeni angazhuar në trajnimet për zbatimin me sukses të sistemit të Prokurimit Elektronik. Cili është roli dhe rëndësia e këtyre trajnimeve?**

Sistemi i Prokurimit Elektronik në Shqipëri filloi të zbatohet për herë të parë nga disa Autoritete Kontraktore pilot, gjatë vitit 2008. Në fund të këtij viti, duke vlerësuar eksperiencën pozitive në këtë drejtim, u morën masa për shtrirjen e aplikimit të prokurimit me mjete elektronike, në masën 100%.

Kryerja e procedurave të Prokurimit në formë Elektronike, përveçse kërkon një platformë ligjore dhe teknike shumë të mirë, mund të realizohet vetëm nëpërmjet një kontributi aktiv të Autoriteteve Kontraktore. Si rezultat, njohja e këtij sistemi nga Autoritetet Kontraktore, është një kërkesë e domosdoshme për aplikimin e tij me sukses. Në këtë kuadër, nisur nga rëndësia e çështjes në fjalë, trajnimi i punonjësve të Administratës Publike të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit, mori një rëndësi të madhe.

**Cilat institucione u angazhuan në ofrimin e këtyre trajnimeve?**

Si përgjegjëse e njesisë së trajnimit pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, e cila është dhe institucioni përgjegjës për aplikimin e kësaj

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

risie në fushën e prokurimit publik, në bashkëpunim të ngushtë dhe me Institutin e Trajnimit të Administratës Publike, hartuam dhe implementuam një plan intensiv trajnimit për të gjithë punonjësit e Administratës Publike në nivel qendror dhe vendor.

Ky program intensiv trajnimi kishte si qëllim njohjen e punonjësve të administratës publike me platformën ligjore dhe atë teknike të sistemit të prokurimit elektronik dhe për këtë arsye mori një rëndësi të veçantë. Realizimi me sukses i këtij programi ishte vendimtar për Sistemin e Prokurimit Publik në Shqipëri gjatë vitit në vijim. Impenjimit tonë maksimal për hartimin e kurrikulave të trajnimit dhe zhvillimin e këtyre trajnimeve, iu përgjigj një interes shumë i madh nga ana e punonjësve të Administratës Publike. Prezantimi i Sistemit të Prokurimit Publik në këto trajnime u prit me shumë interes dhe përgjegjësi maksimale. Në përfundim të kësaj nisme, e cila u shtri në katërmujorin e fundit të vitit 2008



dhe në katërmujorin e parë të vitit 2009, u trajnuan në trajnime dy ditore për përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik 1587 punonjës të Administratës Publike, të cilët përfaqësonin 1093 Autoritete Kontraktore të nivelit qendror dhe vendor.

### **Çfarë rëndësie ka për nëpunësit publikë ofrimi i këtyre trajnimeve?**

Nisma e sipërpërmendur mori një vlerë të veçantë për shkak se përbënte prezantimin e parë të administratës publike me sistemin e prokurimit elektronik, qëllim të cilin e arriti më së miri, megjithatë nuk mund të quhej e plotë dhe e përfunduar, pasi nevoja për trajnime të mëtejshme në këtë drejtim, qëndronte gjithmonë e vlefshme, pasur këtu parasysh dhe përmirësimet e vazhdueshme që i bëheshin Sistemit të Prokurimit Elektronik. Pas kësaj sfide fillestare, të realizuar me sukses, Njësia e Trajnimit pranë APP-së, hartoi dhe realizoi një tjetër program trajnime në fund të vitit 2009, mbi risitë në legjislacionin e Prokurimit dhe në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Edhe eksperiencia nga këto trajnime ishte shumë pozitive. Për t'u theksuar është fakti se u përmbushën pritshmëritë jo vetëm për pjesëmarrjen numerike të punonjësve të administratës publike në këto trajnime (numri total i punonjësve të administratës qendrore dhe vendore që morën pjesë në këto trajnime ishte 2079 pjesëmarrës), por dhe për rolin e tyre interaktiv gjatë zhvillimit të trajnimit. Ky aktivizim i tyre ishte një tregues i qartë i nivelit të njohjes dhe zbatimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik.

### **Si e vlerësoni rezultatin që arritët me ofrimin e këtyre trajnimeve?**

Në përfundim mund të themi se qëllimi i këtyre programeve të



trajnimin është arritur në mënyrë të kënaqshme, gjë që evidentohet në dy mënyra kryesore; së pari duke parë numrin e madh të procedurave të prokurimit të realizuara me sukses nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik nga të gjitha Autoritetet Kontraktore, dhe së dyti nga komentet mjaft pozitive të bëra nga pjesëmarrësit në këto trajnime. Punonjësit e Administratës Publike kanë vlerësuar pozitivisht dhe si shumë të vlefshme në punën e tyre të përditshme, njohuritë e marra në to.

Megjithë rezultatet e arritura, duke qënë se Sistemi i Prokurimit Publik në përgjithësi dhe ai i Prokurimit Elektronik në veçanti, është një proces shumë dinamik, dhe gjithmonë në zhvillim dhe përmirësim, nevoja për trajnime do të mbetet gjithmonë një domosdoshmëri, e cila do të ndikojë drejtëpërsëdrejti në cilësinë e aplikimit të këtij sistemi.

## **Autoriteti Kombëtar për Certifikim Elektronik (AKCE)**

*(AKCE) është institucion publik qendror, me personalitet juridik, në varësi të Ministrisë që cakton Këshilli i Ministrave. AKCE ka selinë në Tiranë dhe gëzon pavarësi të plotë në vendimmarrje për ushtrimin e funksioneve të veta. AKCE financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga të ardhura të krijuara nga veprimtaria e tij.*

### **Nënshkrimi elektronik në e-gov**

Përsosmëria e qeverisjes kërkon që administrata publike të operojë në mënyre të zhdërvjelltë dhe qytetarët të kenë mundësi të penetrojnë burokracinë për të kontaktuar nëpunësin, të zgjedhurin apo përfaqësuesin e tyre. Përfshirja në administratë e mënyrave elektronike të punës siç janë përdorimi i dokumentit elektronik, postës elektronike të sigurt, prokurimit më mjete elektronike, regjistrimit elektronik i biznesit etj., do të sjellin qeverisjen në mënyre elektronike ose siç njihet e government (e-gov). Meqenëse, në pjesën më të madhe të proceseve që përbejnë e-gov, kërkohet identifikimi në rrjet apo server, dërgimi i informacionit në mënyrë të sigurtë, marrja e konfirmimit që mesazhi shkoi në destinacion, përdorimi i Nënshkrimit Elektronik bëhet i pashmangshëm.

Nënshkrimi i bërë dorazi tregon aprovimin e nënshkruesit, siguron origjinalitetin e dokumentit, lidh nënshkruesin me dokumentin, ka vlerë ligjore dhe ka një rol ceremonial. Nënshkrimi elektronik, i cili aplikohet në dokumentin elektronik, përjashtoi rolin ceremonial, ka të njëjtat cilësi me atë të bërë dorazi. Nga ana teknike, nënshkrim

elektronik konsiderohen të dhëna në formë elektronike që integrohen në një dokument elektronik, për të ruajtur origjinalitetin e dokumentit dhe për të vërtetuar dërguesin/marrësin. Nënshkrimi elektronik “buron” nga certifikatat elektronike, të cilat janë nënshkrime elektronike të sigurisë së lartë. Një nënshkrim elektronik që të konsiderohet i certifikuar, duhet të mbështetet nga certifikata që quhen “të kualifikuara” për faktin se, lëshohen nga ente të njohura, të pranuar dhe të regjistruara nga institucioni kompetent.

Ligji ngarkon Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE) për regjistrimin, kontrollin dhe inspektimin e të gjitha enteve, të cilat ushtrojnë aktivitetet që lidhet me shërbimin e certifikimit elektronik. Në fazën e parë që është regjistrimi, të interesuarit paraqesin dokumentacionin e përcaktuar hollësisht në ligj, rregullore dhe udhëzimet e tjera të nxjerra nga Autoriteti. Kërkesa për regjistrim nuk është kërkesë për licencë. Shërbimi i certifikimit elektronik nuk kërkon licencë paraprake por, subjekti, para ose menjëherë me fillimin e aktivitetit duhet të paraqitet pranë qendrës sonë me gjithë dokumentacionin përkatës dhe vetëm certifikimi i bërë nga specialistët e Autoritetit i jep produktit vlerë ligjore. Në vazhdimësi, gjatë ushtrimit të aktivitetit, ofruesit e shërbimit të certifikimit janë objekt i kontrolleve dhe inspektimeve periodike.

Historia e nënshkrimeve elektronike fillon në vitin 1995 në shtetin Utah të SHBA, me Utah Digital Signature Act, me aprovimin e të cilit u ligjërua për herë të parë nënshkrimi i dokumenteve në mënyrë elektronike. Në vitin 1997 ky ligj u adaptua në Gjermani dhe Itali. Përhapja e nënshkrimit elektronik në shtetet e tjera të BE, detyroi komitetin kompetent pranë Bashkimit Evropian të ndërhynte dhe, në vitin 1999, u miratua direktiva kornizë (EU Directive 1999/EC), së cilës

i përmbahen të gjitha ligjet e shteteve anëtare të BE. Edhe Shqipëria si pjesë e zonës ekonomike evropiane dhe kandidate për anëtarësim në BE, në vitin 2008 ka miratuar ligjin “Për nënshkrimin elektronik”, i cili mbështetet plotësisht në Direktivën Evropiane të cituar më sipër.

Nënshkrimi elektronik funksionon mbi bazën e Infrastrukturës së Çelësit Publik (PKI- Public Key Infrastructure). Çdo nënshkrim elektronik përbëhet nga një çift çelësash, njëri i quajtur publik dhe tjetri privat. Çelësi publik është pjesë e PKI, ndërsa çelësi privat mbahet nga nënshkruesi. Kur nënshkrimi elektronik aplikohet në një dokument elektronik, dërguesi përdor çelësin e tij privat për të nënshkruar dokumentin në mënyre elektronike. Marrësi verifikon origjinalitetin e dokumentit të nisur sepse, nëpërmjet PKI atij i dërgohet edhe informacioni i nevojshëm që përmban informacion që do të identifikojë dhe vërtetojë autorësinë e dërguesit që ka nënshkruar dokumentin. Nënshkrimi elektronik jep garancinë dhe sigurinë e nevojshme që dokumenti i nisur është origjinal, identifikon dërguesin/marrësin dhe nëpërmjet vulës kohore vërteton kohën kur është nisur/marrë dokumenti elektronik.

Vlerat e përdorimit të nënshkrimit elektronik janë të mëdha. Dokumenti elektronik me nënshkrim elektronik të integruar është i sigurtë dhe i besueshëm në origjinalitetin e tij. Kjo bën që shumë marrëdhënie të kryhen *online*, p.sh. lidhja e kontratave, kryerja e blerjeve, veprimet bankare, prokurimet, etj. Për sa i përket vlerave, le të marrim rolin e nënshkrimit elektronik në administratë. Aktualisht, korrespondenca brenda dhe jashtë institucioneve kryhet me shkresë letër të firmosur dhe vulosur nga titullari i institucionit. Mesatarisht në vit, një ministri përpunon rreth 30 mijë shkresa, konsumon rreth 3500 pako letër format ( 1 milion e 750 mijë fletë) dhe rreth 750 kuti boje (printer, faks, fotokopje). Secila nga këto shkresa brenda institucionit

kërkon disa orë përpunim dhe jashtë institucionit mesatarisht 5 ditë. Përdorimi në administratë i dokumentit elektronik dhe pajisja e të gjithë nëpunësve (rreth 130 mijë) me nënshkrim elektronik do të pasohet me ulje të kostos financiare dhe kohore, rritje të efektivitetit, fleksibilitetit, sigurisë, përgjegjshmërisë dhe transparencës.

Me interesimin dhe investimet e bëra nga qeveria vitet e fundit në fushën IT, prapambetja e trashëguar e administratës publike në teknologji dhe njohuri po mbetet pas dhe kuptohet lehte se në Shqipëri “era” dixhitale nuk ka qenë një fllad pranveror. Çdo gjë po ecën shumë shpejt dhe në drejtimin e duhur. Është një fillim i ri dhe gjithçka ka rolin e vet, që nga pajisja me laboratorët kompjuterike dhe me shërbimin e internetit në çdo shkollë, plotësimi i legjislacionit, futja e shërbimeve *online* për qytetarët etj. Në të gjitha këto, nënshkrimi elektronik ka rol të rëndësishëm dhe të gjitha bashkë do të krijojnë kushtet për një qeverisje elektronike efikase dhe ku do të dëgjohet zëri “*online*” i qytetarëve dhe komuniteteve.

### **Votim elektronik edhe në Shqipëri**

Në një shtet demokratik, me votim të lirë dhe të fshehtë qytetari-votues ka privilegjin të zgjedhë si dhe nga cilët do të qeveriset. Ligji elektoral duhet të përcaktojë rregullat për një proces të ndershëm dhe të krijojë të gjithë mekanizmat e nevojshme që në rast kontestimesh të jetë e mundur transparenca dhe mosbllokimi i procesit. Në përfundim, secila palë duhet të jetë e bindur dhe të pranojë se, rezultati ishte i vërtetë dhe ta njohë atë.

Procesi zgjedhor në Shqipëri, në të gjithë infrastrukturën e tij, ka qenë mjaft dinamik. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, përveç mjeteve

klasike si fletët, listat, komisionet, procesverbalet dhe kutitë, kishte edhe të reja, siç ishin skanimi, publikimi dhe regjistrimi elektronik i fletëve të votimit gjatë numërimit. Pra, elektronika është afruar tek zgjedhjet shqiptare.

Votimi elektronik, që aplikohet sot në shumë shtete, ndahet në atë me mjete elektronike në qendra votimi dhe *online*. Ndryshimi mes tyre është se, i pari kryhet në një mjedis të përcaktuar, në të cilin janë vendosur mjete elektronike dhe ka një komision modest në numër (kryesisht asistencë teknike) dhe *online* nga çdo kompjuter me lidhje interneti, pa praninë e komisioneve apo asistencën e ekspertëve.

Sot me diskutimin e hapur për ndryshimin e ligjit zgjedhor dhe votimin e përzier me fletë dhe elektronik, ose krejtësisht elektronik, organizatorët e zgjedhjeve duhet të sigurojnë po ato kritere që garanton edhe sistemi klasik me fletë letre. A është e mundur? Teorikisht po, sepse është aplikuar dhe aplikohet në vende të tjera. Praktikisht, si?! Në votimet tradicionale me fletë votimi, skemat e votimit duhet të sigurojnë se, pa të drejtë vote dhe më shumë se një herë nuk mund të votohet, vota do të jetë e fshehtë dhe e lirë, votuesi nënshkruan që votoi, votimi nuk do të pengohet qëllimisht dhe votat do të numërohen ashtu siç janë hedhur.

Sot, Shqipëria ka regjistrin elektronik të zgjedhësve dhe kartën e identitetit elektronike, nënshkrimi elektronik i instaluar në kartë mundëson identifikimin e mbajtësit, të gjitha së bashku eliminojnë personat pa të drejtë vote p.sh. ato nën moshë, sistemi nuk lejon të votosh më shumë se një herë, sepse certifikata e instaluar në kartë e identifikon votuesin, vota është e fshehtë, kjo mund të sigurohet nëpërmes kriptografisë, me anë të nënshkrimit elektronik verifikohet se

u votua dhe vota u numërua, votuesi është i lirë të zgjedhë, arritur kjo edhe në zgjedhjet e 2009, votimi nuk pengohet qëllimisht, sepse nuk ka kontestime për vendime të marra nga mjetet elektronike, të cilat nuk njohin përkatësinë partiake.

Nga eksperiencat e mëparshme, sidomos nga ajo e votimeve të vitit 2009, kontestimet fillojnë gjatë administrimit të votave, pra, si numërohen votat dhe sa i besueshëm është rezultati. Në votimin elektronik i gjithë procesi varet nga siguria e programit kompjuterik (*software*) që do të procesojë votat dhe do të nxjerrë rezultatin e asaj pjesë të votuesve që kanë preferuar votimin elektronik. Në qoftë se, sistemi ndërtohet në mënyrë të njëanshme, atëherë ky sistem është i pasigurte dhe jo i besueshëm. Zgjidhja vjen nga ekspertët e përbashkët të palëve të interesuara, të cilët do të testojnë dhe më pas do të certifikojnë programin kompjuterik (*software*) dhe pajisjet (*hardware*). Në qoftë se, palët pranojnë të futen në zgjedhje me atë sistem dhe me ata ekspertë, atëherë ata duhet të pranojnë rezultatin e dalë.

Rezultati përfundimtar i votimit elektronik, që do të jepet disa sekonda pas mbylljes së pajisjes së fundit të votimit bëhet pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe numërimi kryhet në mënyrë elektronike. Pra, faktori njeri, që aktualisht është i pabesueshëm, shmanget plotësisht nga numërimi. Gjithashtu, një avantazh i votimit elektronik është shmangia e gabimit njerëzor në zgjedhjen e subjektit. Teksti udhëzues që do të drejtojë votuesin gjatë votimit mund të ndërtohet në atë mënyrë që të reduktojë në zero përqindjen e votave të pavlefshme.

Zgjedhjet, kryesisht ato parlamentare, janë objekt debatesh edhe në vende me demokraci të konsoliduar, kështu që në Shqipëri edhe për shumë kohë zgjedhjet edhe mund të kontestohen. E vetmja mënyrë e

reduktimit të ndjeshëm të kontestimeve është që zgjedhje pas zgjedhesh të shkohet drejt votimit të plotë elektronik. Çdo qeveri duhet të ketë detyrë ligjore përgatitjen e infrastrukturës përkatëse, shoqëruar me një edukim zgjedhor që do të nisë që në shkolla.

Teknikisht, me regjistrin elektronik të zgjedhësve, kartën elektronike të identitetit, nënshkrimin elektronik që krijon mundësitë për të nënshkruar dhe për t'u identifikuar në rrjet, resurset tekniko-profesionale dhe dëshirën që kanë të gjithë për zgjedhje të rregullta, në votimet e 2013 ose më parë, shqiptarët që dëshirojnë mund të votojnë edhe në mënyrë elektronike.

**Sadi Hoti**

Drejtor

Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik



## **Mbështetja e Donatorëve në zhvillimin e shërbimeve elektronike**

### **- USAID dhe kontributi i saj në zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit**

Të nderuar lexues,

Në vetëm katër vjet, mjedisi i biznesit në Shqipëri ka pësuar një ndryshim të thellë. Vetëm tre vjet më parë, regjistrimi i biznesit ishte një proces që kushtonte shtrenjtë dhe kërkonte shumë vajtje-ardhje në gjykatë dhe zyra të institucioneve publike. Ofertuesit për prokurimet publike duhej të paguanin për të marrë dokumentet e tenderit dhe shpesh (zyrtarisht ose jozyrtarisht) prokurimet i drejtoheshin një ofertuesi. Tatimpaguesve iu duhej të rrinin në radhë ose të paguanin ndonjë inspektor për të marrë formularët tatimore apo për të negociuar detyrimet e tyre tatimore. Ata ishin të detyruar të planifikonin fluksin e parave pa ditur se çfarë i detyroheshin shtetit. Marrja e një licence biznesi do të thoshte shpenzim parash, kohe dhe energjie për t'ia dalë mbanë sistemit të komplikuar dhe të lodhshëm të licencimit të biznesit.

Sot, regjistrimi i biznesit kërkon vetëm një aplikim, i cili përpunohet brenda 24 orëve me një kosto për biznesin prej rreth një dollari. Të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale duhet t'i publikojnë njoftimet e tenderave në një faqe publike në internet, nga e cila bizneset mund të shkarkojnë dokumentet e tyre falas. Përmes saj ata mund të dërgojnë elektronikisht dhe ofertat. Bizneset mund të shkarkojnë formularët tatimore nga faqja e internetit e administratës tatimore dhe të deklarojnë tatimet e tyre në mënyrë elektronike. Në internet ata mund të gjejnë gjithashtu pjesën më të madhe të informacionit të nevojshëm mbi licencimin dhe për të gjitha pyetjet e aplikimet për shumicën e licencave iu duhet vetëm një adresë: Qendra Kombëtare e Licencimit.

Këto ndryshime rrënjësore janë rezultat i reformave të thella gjithëpërfshirëse në regjistrimin e biznesit, administratën tatimore, prokurimet publike dhe licencimin e biznesit të bëra realitet me mbështetjen e Programeve Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit në Shqipëri.

Programi i parë dyvjeçar, me vlerë \$13,85 milion, filloi në vitin 2006. Ky program ndërmjet qeverisë shqiptare dhe Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (MÇ), i cili administrohet nga USAID, ndihmoi në reformimin dhe modernizimin e administratës tatimore, prokurimit publik dhe regjistrimit të biznesit duke vënë në jetë zgjidhje të teknologjisë së informacionit dhe përmirësime legislative. Aktualisht po zbatohet një program tjetër dyvjeçar MÇ-Shqipëri, me vlerë \$15,7 milionë, i cili ka për qëllim të forcojë shtetin ligjor, të reduktojë korrupsionin dhe të rrisë mbikëqyrjen nga publiku përmes zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit dhe ndihmës teknike, duke përmirësuar kështu klimën për biznes në Shqipëri.

Baza e reformave të ndërmarra me mbështetjen e Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit është futja për herë të parë në Shqipëri të zgjidhjeve të qeverisjes elektronike për regjistrimin dhe licencimin e biznesit, në prokurimin publik, administratën tatimore dhe planifikimin e territorit. Me adoptimin e këtyre zgjidhjeve, Shqipëria ndjek shembullin e qeverive në të gjithë Evropën dhe në botë. Sistemet e qeverisjes elektronike u kursejnë kohë dhe para si qeverisë dhe privatëve, ndërkohë që rrisin transparencën, përgjegjshmërinë, besueshmërinë dhe nivelin e përdorimit. Në vende si Shqipëria me tregje të brendshme të vogla, përmirësimet e ndjeshme në mjedisin e biznesit mund të sjellin një ndryshim thelbësor në rritjen e fluksit të investimeve të huaja direkte dhe të inkurajojnë qytetarët të investojnë në ekonominë lokale. Nga ana tjetër, një mjedis përkrahës për biznesin mund të nxisë legalizimin e

ekonomisë informale, duke ndihmuar në krijimin e bizneseve të vogla apo vetëpunësimin, si motorë kryesorë të rritjes ekonomike. Në të njëjtën kohë, qeveria mund të përfitojë nga rritja e të ardhurave tatimore dhe zvogëlimi i shpenzimeve operative.

Mënyra më e mirë për të treguar ndikimin e reformave të qeverisjes elektronike në Shqipëri është t'ju paraqesim disa histori të shkurtra e të thjeshta personale se si këto shërbime elektronike e kanë bërë më të lehtë, më të shpejtë dhe më të efektshëm që të merresh me biznes në Shqipëri. Këto histori janë si foto të bëra disa muaj pas futjes në përdorim të shërbimeve elektronike. Ato bëjnë fjalë për ndryshime të rëndësishme dhe shpesh si nata me ditën me më parë, në përmirësimin e klimës së biznesit në vend. Ju mund të gjeni dhe histori të tjera si këto, ashtu si dhe të lexoni mbi reformat dhe sistemet e qeverisjes elektronike të mbështetura nga MÇ, duke vizituar faqen tonë në internet te [www.mcata.org.al](http://www.mcata.org.al)

**Richard Wolfe**

Drejtor

Programi Prag MCC Shqipëri II

## **Disa nga arritjet e Programit Prag MCC Shqipëri II**

### **-Forcimi i shtetit ligjor dhe rritja e besimit të publikut**

Çështjet gjyqësore administrative, të cilat kanë të bëjnë me ankesa ndaj institucioneve publike, bëhen shpesh pre e korrupsionit, duke qenë se ato janë jo rrallë komplekse dhe jo të kuptuara si duhet. Ky projekt do të mbështesë krijimin e një sistemi gjykatash të specializuara administrative për të gjykuar këto raste mosmarrëveshesh. Projekti me vlerën e 15.7 milion dollarë që nga janari i 2009 për rreth 3 vjetesh synon të kontribuojë në forcimin e shtetit ligjor, të reduktojë korrupsionin dhe të rrisë mbikëqyrjen nga publiku përmes zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit dhe ndihmës teknike, duke përmirësuar kështu klimën për biznes në Shqipëri nëpërmjet:

- Hartimit të procedurave të punës për Gjykatat Administrative.
- Krijimit dhe instalimin e programeve kompjuterike të menaxhimit të çështjeve gjyqësore.
- Trajnimit të gjykatësve, avokatëve dhe nëpunësve civilë.
- Informimit të publikut dhe rritjen e besimit në sistemin gjyqësor.

Nismë kryesore e programit MCCA2 është zhvillimi i një sistemi të teknologjisë së informacionit për të menaxhuar ecurinë e çështjeve në gjykatat administrative. Sistemi do të ketë një portal informimi publik në internet, nga ku do të ofrohet qasje dhe të vendimet gjyqësore të marra.

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

Deri tashmë, ka përfunduar versioni i parë funksional i një sistemi të ri elektronik modern për menaxhimin e çështjeve gjyqësore në gjykatat e ardhshme administrative, i zhvilluar në bazë të një procesi bashkëpunimi gjithëpërfshirës.



*Gjyqtarë të ardhshëm, studentë të Shkollës së Magjistraturës, marrin pjesë në testimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, i cili po zhvillohet nga MCCA2 për gjykatat e ardhshme administrative në Shqipëri.*

## Rritja e efikasitetit dhe transparencës për lejet e ndërtimit

Procesi i lejeve të ndërtimit është ndër procedurat administrative më pak efektive dhe deridiku me më shumë rezistencë ndaj reformave në Shqipëri. MCCA2 punon për modernizimin e procesit të planifikimit të territorit dhe reduktimin e mundësive për korrupsion në dhënien e lejeve të ndërtimit. Ai mbështet krijimin e një regjistri elektronik me rregulloret dhe udhëzimet për planifikimin e territorit dhe lejet e ndërtimit. Përmes internetit, ky Regjistër do t'i ofrojë publikut informacion mbi kriteret e përdorimit dhe zhvillimit të territorit dhe do të sigurojë transparencë dhe qasje për individët e bizneset e interesuara në zhvillimin e pronave.

Projekti është një marrëveshje dyvjeçare, me vlerë \$15.7 milionë, ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA-së, e cila ka për qëllim të forcojë shtetin ligjor, të reduktojë korrupsionin dhe të rrisë mbikëqyrjen nga publiku përmes zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit dhe ndihmës teknike, duke përmirësuar kështu klimën për biznes në Shqipëri. Dy veprimtaritë kryesore të tij janë:

- *Ofrimi përmes internetit të informacionit për planifikimin e territorit dhe marrjen e lejeve të ndërtimit.* Programi do të zhvillojë, testojë dhe instalojë në një agjenci qendrore për planifikimin e territorit dhe në pesë bashki një regjistër elektronik, i cili do të përfshijë një portal në internet me informacion mbi rregullat për planifikimin e territorit dhe procedurat për dhënien e lejeve të ndërtimit, si dhe një mekanizëm për ndjekjen dhe inspektimin e procesit të lejeve, i cili mundëson dhe ndjekjen e ecurisë së aplikimeve përmes internetit. Deri tani është zhvilluar një version beta i portalit informativ në internet mbi planifikimin e territorit dhe ka filluar puna për transferimin e tij te Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT).

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

- *Ndërgjegjësimin e publikut mbi Regjistrin dhe monitorimin e tij. Fushata për informimin e publikut mbi Regjistrin e Planifikimit të Territorit do të realizohet paralelisht me përpjekjet për të angazhuar të gjitha palët e interesuara në diskutime për nxitjen e reformave në planifikimin e territorit dhe procedurat për lejet e ndërtimit, si dhe për të mbështetur monitorimin e këtyre reformave nga shoqëria civile.*



*Përfaqësues të qeverisë shqiptare, të Bashkisë së Vlorës, tëUSAID-i dhe MCCA2 diskutojnë së bashku mbi reformën në planifikimin e territorit.*

## Efiçencë, transparencë dhe llogaridhënie në Administratën Tatimore

Komponenti për Administratën Tatimore vazhdon misionin e suksesshëm të fazës së parë me synim ndërtimin e një administrate tatimore moderne dhe të mirëorganizuar që funksionon në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare dhe redukton korrupsionin në mbledhjen e tatimeve, në përputhje me ligjin për procedurat tatimore të vitit 2008.

Faza e dytë e Programit MCCA2, që nga janari 2009, është një marrëveshje dyvjeçare me vlerë 15.7 milionë dollarë ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara, e cila ka për qëllim të forcojë shtetin ligjor, të reduktojë korrupsionin dhe të rrisë mbikëqyrjen nga publiku përmes zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit dhe ndihmës teknike, duke përmirësuar kështu klimën për biznes në Shqipëri nëpërmjet:



### DEKLARIMI ELEKTRONIK I TATIMEVE



*Njëzetmijë kopje të broshurës mbi deklarin elektronik të tatimeve janë shpërndarë në të pesëmbëdhjetë drejtoritë tatimore në Shqipëri dhe janë në dispozicion të tatimpaguesve.*





- Finalizimit të riorganizimit funksional dhe gjeografik të Administratës Tatimore.
- Ngritjen e mekanizmave të hetimit.
- Krijimin e programeve për asistencë ndaj taksapaguesve.
- Deklarimin dhe pagesën elektronike për të gjithë tatimpaguesit.

### **Krijimi i një procesi efektiv dhe transparent për licencimin**

Në zbatim të ligjit për licencat të shkurtit 2009, i cili reformon procedurat e licencimit të biznesit që konsiderohet si burim korrupsioni dhe barrierë për të bërë biznes në Shqipëri, MCCA2 mbështet ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të shërbimit me një ndalesë për dorëzimin dhe ndjekjen në mënyrë elektronike të aplikimeve për licenca përmes Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL).

Kjo është një marrëveshje dyvjeçare me vlerë 15.7 milion dollarë, e cila ka për qëllim të forcojë shtetin ligjor, të reduktojë korrupsionin dhe të rrisë mbikëqyrjen nga publiku përmes zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit dhe ndihmës teknike, duke përmirësuar kështu klimën për biznes në Shqipëri përmes:

Krijimit të QKL-së me procedura të standardizuara dhe sportele shërbimi rajonale. Angazhimi përfshin hapjen dhe funksionimin e qendrës me një ndalesë për licencat në bazë të një sistemi elektronik që mbështet punën e një rrjeti sportelesh shërbimi në të gjithë vendin.

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

Dorëzimit dhe ndjekjen elektronikisht të aplikimit për licencë dhe shkëmbimin e rregullt të të dhënave ndërmjet institucioneve. Karakteristikat e sistemit të QKL-së përfshijnë krijimin e regjistrit kombëtar të licencave, si dhe mundësinë për dorëzimin dhe ndjekjen e aplikimeve përmes internetit, duke lejuar shkëmbimin e vazhdueshëm të të dhënave me institucionet e tjera.

Ndërgjegjësimit të publikut për QKL-në dhe monitorimin e saj. Veprimtaritë përfshijnë organizimin e një fushate për informimin e publikut, ndihmën për të ngritur një njësi informacioni të QKL-së, si dhe mbështetje për nisma monitorimi nga shoqëria civile.



*Tani bizneset mund të plotësojnë shumicën e nevojave të tyre në fushën e licencimit në Qendrën Kombëtare të Licencimit, e cila ofron shërbim me një ndalesë, të shpejtë e transparent.*

### REZULTATET E ARRITURA

- *Janë hartuar dhe miratuar aktet nënligjore për QKL-në, si dhe amendimet e 64 ligjeve sektoriale.*
- *Në qershor 2009, u hap në Tiranë selia e QKL-së, e cila ofron shërbim me një ndalesë përmes një sistemi të teknologjisë së informacionit në përputhje me parametrat e BE-së dhe me një portal në internet te [www.qkl.gov.al](http://www.qkl.gov.al), ku bizneset mund të ndjekin ecurinë e aplikimeve, të gjejnë informacion për licencat dhe lejet në Shqipëri, si dhe të shohin listën e të gjitha licencave të miratuara nga QKL-ja.*
- *Falë një marrëveshjeje me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), që nga muaji dhjetor 2009 janë hapur nëntë sportele shërbimi të QKL-së pranë atyre të QKR-së në Korçë, Shkodër, Vlorë, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Berat, Peshkopi dhe Elbasan.*
- *Janë trajnuar punonjësit e QKL-së dhe të ministrive të linjës për kuadrin ligjor; procedurat dhe sistemin elektronik të licencimit.*
- *Në qershor-korrik 2009 u zhvillua një fushatë e shumëanshme informimi në të gjithë vendin, e cila është pasuar nga veprimtari të tjera si botimi i një broshure me pyetje-përgjigje, i posterave e kartolinave informative.*
- *Po punohet për thjeshtimin e mëtejshëm të procesit të licencimit, si dhe reduktimin e kohës për miratimin e licencave dhe të kostos së biznesit për t'i marrë ato, duke identifikuar hapësirat për përpunimin e licencave të tjera përmes QKL-së.*

## **Rritja e besimit dhe mbikqyrjes nga publiku**

Si pjesëmarrëse në konsultime mbi reformat ose si monitoruese e tyre, shoqëria civile luan një rol vendimtar në rritjen e llogaridhënies nga qeveria apo gjykatat. MCCA2 synon të forcojë besimin e publikut në administratën publike dhe gjykatat përmes fuqizimit të mbikqyrjes së tyre prej tij.

Një marrëveshje dyvjeçare me vlerë 15.7 milion dollarë ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara, ka për qëllim të forcojë shtetin ligjor, të reduktojë korrupsionin dhe të rrisë mbikqyrjen nga publiku përmes zgjidhjeve së teknologjisë së informacionit dhe ndihmës teknike, duke përmirësuar kështu klimën për biznes në Shqipëri, nëpërmjet:

- Rritjes së aftësisë së grupeve të shoqërisë civile për t'u bërë avokatë të ligjeve dhe politikave të reja.

- Forcimit të aftësive monitoruese të grupeve të shoqërisë civile për reformat. Me qëllim rritjen e transparencës dhe të mbikqyrjes, MCCA2 financon monitorimin e reformave të mbështetura prej tij, siç është funksionimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe asaj të Licencimit (QKL), i sistemit të prokurimit elektronik, i shërbimeve elektronike të tatimeve dhe i shërbimit ndaj tatimpaguesve.

- Fuqizimit të organizatave të shoqërisë civile.

Deri tani mund të përmendim këto arritje:

- Ka përfunduar raundi i parë i nënkontratave të monitorimit, ku AmCham zhvilloi një sondazh për sistemin e prokurimit elektronik, Partnerët Shqipëri për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe IDRA për shërbimet elektronike të tatimeve.

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

- Ka filluar zbatimi i një raundi të dytë nënkontratash për monitorimin e QKL-së dhe të shërbimit ndaj tatimpaguesve.
- Janë organizuar konsultime në tryeza të rumbullakëta me biznesin në lidhje me reformën e licencimit, shërbimet dhe portalin në internet të QKL-së, platformën e bazuar në zgjidhje të teknologjisë së informacionit për regjistrin e planifikimit të territorit, aktet nënligjore mbi këtë regjistër, si dhe misionin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ Tatimor.
- Në prill-maj 2009 u realizua vlerësimi i kapaciteteve për avokim i 30 organizatave të shoqërisë civile, në bazë të cilit u ndërtua një program i posaçëm ndihme dhe trajnimi.
- Është ofruar trajnim i avancuar për rritjen e kapaciteteve për avokim dhe ndihmë e drejtpërdrejtë për përpjekje avokimi, si ajo në përkrahje të gjykatave administrative, duke përfshirë mbi 750 anëtarë të organizatave të shoqërisë civile.



## **Roli i PNUD-it në Shqipëri në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit**

Prej shumë vitesh, PNUD në Shqipëri ka ndërtuar një bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë, duke mbështetur tranzicionin e vendit drejt një shoqërie të informacionit nëpërmjet zhvillimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK). Kjo mbështetje ka përfshirë një ndihmë të specializuar teknike në hartimin e dy Strategjive Kombëtare TIK (në 2003 dhe 2008), iniciativën për futjen e kompjuterit në shkolla, ngritjen e Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHi), projektimin dhe ndërtimin e rrjetit elektronik të qeverisë (GovNet), kontabilitetit elektronik, një grup i dokumenteve të politikës kyçe të tilla si: studimi për politikën e sigurisë së komunikimit elektronik, studimet për Intra dhe Internet, etj. Si rezultat i këtij kontributi të suksesshëm, Kryeministri Berisha i ka kërkuar PNUD-it të vazhdojë të zgjerojë asistencën e tij në TIK, duke e bërë atë një përparësi në ciklin e ardhshëm të programit të asistencës së PNUD.

PNUD në Shqipëri ka punuar gjithmonë me një staf me përvojë dhe të përkushtuar, me njohuri të thella për kushtet e Shqipërisë, ka identifikuar partnerë të mundshëm për bashkëpunim në TIK, si dhe ka mobilizuar dhe garantuar ekspertizën teknike të nevojshme. Ky staf ka punuar në projekte të ndryshme të TIK me Qeverinë në përmirësimin e infrastrukturës së TIK në institucionet qeveritare, ngritjen e rrjetit VoIP për qeverinë, iniciativën për “shkollat online”, vendosjen e sistemit kontabël online në Ministrinë e Financave, etj.

PNUD ka përfunduar programin mbështetës për fuqizimin e AKSHIt, duke e ndihmuar atë në aspektet e politikës dhe strategjisë së TIK, menaxhimit të dokumentacionit dhe arkivimit dixhital, kurrikulat e TIK, arkitekturën dhe standardet e TIK, kuadrin ligjor për bandën e gjerë, etj..., si edhe një studim paraprak mbi bashkëveprimin e sistemeve të ndryshme TIK (e njohur edhe si rruga-X) për qeverinë shqiptare që konsiston në standardizimin e të gjithë sistemeve të informacionit dhe bazave të të dhënave ekzistuese dhe ato të ardhshme. PNUDit i është kërkuar kohët e fundit nga Qeveria që të mbështesë kompjuterizimin e sistemit të taksave në Shqipëri. Të gjithë këto komponente të zhvillimit të TIK në Shqipëri, si edhe asistenca e BE-së nëpërmjet fondeve IPA dhe ajo e USAID kontribuojnë që rezultatet arritura nga projektet e UNDP në Shqipëri të plotësojnë infrastrukturën dhe përmbajtjen e teknologjisë së informacionit si një element i domosdoshëm i qeverisjes demokratike.

PNUD në Shqipëri ka krijuar një marrëdhënie të shkëlqyer tashmë me qendra rajonale të ekselencës në fushën e teknologjisë së informimit dhe komunikimit TIK, si Akademia e Qeverisjes Elektronike në Estoni; Qendra e Qeverisjes Elektronike në Lubjanë për Europën Jug-Lindore, iniciativa e-SEE në Sarajevë, etj. Ndërkohë, kërkohen angazhime dhe përpjekje të tjera nga ana e Qeverisë për një zhvillim edhe më të gjerë e më të thellë në proceset e TIK.

Rritja e numrit të personelit të angazhuar në TIK në institucionet shtetërore, rritja e buxhetit për TIK, si dhe disa hapa të mëtejshëm për qeverisjen elektronike dhe mbrojtjen e të dhënave janë të nevojshme për të vënë në eficiencë arritjet e deritanishme dhe për të krijuar kushtet për një fazë të re të zhvillimit të një shoqërije të informacionit në Shqipëri.

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

Planet e ardhshme për zhvillimin e TIK në Shqipëri kërkojnë një menaxhim dhe koordinim strikt të ministrive dhe institucioneve në kryerjen e detyrave të tyre specifike në fushën e Teknologjisë së Informacionit.

Besimi i Qeverisë e ka vendosur PNUD-in në një pozicion të tillë që sot ajo kryen një monitorim të plotë të të gjitha zhvillimeve në infrastrukturen dhe kapacitetet njerezore të TIK, në bashkëpunim me Ministrin për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit.

Ky Ministër dhe AKSHi koordinojnë aktorët e ndryshëm kombëtarë e ndërkombëtarë nëpërmjet formave të ndryshme të konsultimeve dhe me mbështetjen e PNUDit:

- Një nivel të lartë konsultimesh për të angazhuar të gjithë aktorët e mundshëm në mbështetjen e zhvillimeve të TIK (përfshirë edhe kontribute të ndryshme në buxhetin që kërkon TIK në Shqipëri);

- Një përfshirje në këto konsultime të përfaqësuesve të sektorit privat të TIK, shoqërisë civile dhe burimeve akademike, në mënyrë që të sigurohet edhe pjesëmarrja e tyre dhe ekspertiza e tyre për zhvillimin e TIK në Shqipëri.

**Arben Rama**

Menaxher

Departamenti i Qeverisjes Demokratike në Shqipëri

PNUD



## **Shifra dhe Fakte**

- Me shumë se 23 institucione që përfshijnë të gjitha Ministrinë Qendrore, INSTAT dhe Zyra e Publikimeve, Departamenti i Administratës Publike, Parlamenti Shqiptar, Agjencia e Kompensimit dhe Kthimit të Pronave dhe Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile janë të lidhur në një rrjet me fibra optike, që ofron një gjerësi bande prej 100 Mbps



- Më shumë se 1,129 punonjës të administratës publike përfitojnë çdo ditë në punën e tyre mbrojtje me Antivirus dhe antispam të sistemit të ri të e-mailit
- Me shumë se 3740 m fibra optike janë në pronësi të qeverisë.
- Janë kryer 4 studime gjithëpërfshirëse analitike për VOIP në kuadër të politikave e procedurave për shërbimet Intranet

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

- Sistemi VOIP është integruar si pjesë e GovNet për të siguruar komunikimin ndërmjet institucioneve qeveritare me kosto zero

- Eshtë krijuar Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHi) për të koordinuar dhe monitoruar zhvillimin e TIK në Shqipëri



- Një ligj i ri kontabiliteti dhe IPSAS është miratuar bashke me standardet IFRS te cilet janë përkthyer dhe integruar nga Ministria e Financave

- Specialiste të fushës së teknologjise së informacionit dhe komunikimit të qeverise janë trajnuar në modulin “Zbulim dhe eksplorim CISCO”

- Eshtë ndërtuar një sistem inventarizimi i administruar nga Ministria e Financave

## **- BE dhe kontributi i saj në zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit**

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është integruar sot në të gjitha aspektet e jetës moderne, si për biznesin, konsumatorin dhe vetë qeverinë. Prandaj TIK është një komponent esencial i modernizimit të kapaciteteve administrative në Shqipëri. Janë të shumta aktivitetet e ndryshme të lidhura me TIK të mbështetura me fonde të BE-së dhe të donatorëve të tjerë, si p.sh.: modernizimi i sistemit të adresave dhe Regjistrimit civil, etj.

Në këtë kuadër, me kontribut të Komisionit Europian, nën iniciativën e programit CARDS, 2005, nisi zbatimin e projektit “Reforma në administratën Publike në qendër të qeverisë”, me qëllimin për të mundësuar infrastrukturën mbështetëse TIK. Ky projekt është zbatuar në dy komponentë:

(1) përmirësimi i infrastrukturës bazë të IT për Administratën publike.

(2) Asistencë teknike për AKSHi-n.

Si një ndër komponentët e rëndësishëm të këtij projekti, mund të përmendim komponentin 4, “Përmirësimi i transparencës dhe eficiencën e procedurave administrative publike, nëpërmjet TIK”. Objektivi kryesor i këtij komponenti, u fokusua në mundësimin e një mjedisi të mbështetur nga TIK, me të cilin institucionet publike bëhen më eficiente dhe të përgjegjshme për publikun, lidhur me shpërndarjen e informacionit dhe sigurimin e shërbimeve publike.

Gjithashtu, Bashkimi Europian, përmes partneritetit me Shqipërinë, ka mbështetur qeverinë shqiptare në inkurajimin dhe forcimin e TIK, përmes Planit Kombëtar për zbatimin e MSA- së me BE.

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

Në kuadrin e kësaj mbështetjeje, përmendim projektin e financuar nga BE në kuadrin e CARDS 2005, mbi bazën e të cilit u investuan 800 mijë euro për pajisje hardware IT, për të gjithë administratën publike, ndërsa 200 000 euro u përdorën nga ky projekt për asistencën teknike mbi kuadrin ligjor për TIK. Aktualisht, është duke u implementuar projekti IPA 2009. Objektivi i Projektit është “Ndërtimi i infrastrukturës e- Government për përmirësimin e transparencës dhe eficiencës së administratës publike, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me standardet evropiane”. Kontributi i Komisionit European për këtë projekt është 4 milion euro dhe ai i qeverisë shqiptare 1.2 milion euro.

Ky projekt është në konformitet të plotë me “2010 Action Plan and eSEE Agenda+” dhe ka për qëllim plotësimin e dy prioriteteve kryesore të MSA-së në zbatim të Nenit 79, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe neneve 103, 104 dhe 105 në lidhje me Shoqërinë e Informacionit, Komunikimeve Elektronike, Informacionit dhe Komunikimit. Aktivitetet e foksuara në kuadër të këtij projekti, përfshijnë:

- Zhvillimin e infrastrukturës së sistemit elektronik të ndërveprueshëm (ISEN);
- zhvillimin e Strategjisë dhe mjedisit për shërbimet elektronike duke përfshirë përgatitjen e teknologjive, platformave dhe arkitekturave të shërbimeve për zhvillimin e shërbimeve dinamike dhe statike;
- draftimin e kuadrit ligjor për ofrimin e shërbimeve elektronike dhe të sistemit të ndërveprimit;
- Organizimin e fushatave sensibilizuese për ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve elektronike;
- Zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit të Dokumenteve dhe të Arkivimit Dixhital, duke përfshirë studimin e vizibilitetit, përgatitjen e

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

TOR për dizenjimin dhe implementimin e këtij sistemi me institucionet qeveritare;

- Përmirësimi i funksionimit të KMDP duke përfshirë ekspertizë ligjore për draftimin e kuadrit ligjor të nevojshëm për përmirësimin e funksionimit të KMDP, në përputhje me standardet dhe direktivat e BE-së, si dhe organizimin e trainimeve, workshopeve të ndryshme.

BE ka kontribuar edhe me projekte të tjera, pjesë përbërëse e të cilave kanë qenë edhe komponentë të zhvillimit apo modernizimit përmes TIK. Me mbështetjen e BE-së dhe UNDP, është mundësuar zhvillimi i modulit të parë të rrjetit qeverisës. Ky propozim siguron mbështetje për administratën publike në zbatimin e shërbimeve e- Gov.

Gjithashtu, në kuadër të programeve PHARE, CARDS 2003, CARDS 2004, IPA 2008, apo nga Banka Botërore, në kuadër të Programit për Reformën në Administratën Publike (PARP). Në mbështetje të reformës në administratën publike, donatorë të ndryshëm, kanë asistuar në nivel teknik edhe Departamentin e Administratës Publike (DAP).

Donatorë të tjerë të rëndësishëm, që kanë mbështetur në iniciativa dhe periudha të ndryshme DAP janë: UNDP, OSCE, GTZ, SIGMA, INĒENT, SOROS, etj. DAP, mbështetur në prioritetet e qeverisë shqiptare për të realizuar me sukses reformën në administratën publike, koordinon ndihmën teknike dhënë nga donatorë të ndryshëm në kuadër të modernizimit të shërbimit civil dhe administratës publike në tërësi. Kështu, DAP, në mënyrë të vazhdueshme analizon progresin e bërë dhe nxjerrë në pah sipas fushave, nevojat për financime të mëtejshme.

Në këtë kuadër, DAP:

- ka përfituar asistencë teknike nga Banka Botërore, (2009 – 2010) në kuadër të “Trust Fund” për “Forcimin e Kapaciteteve Menaxhuese të Administratës Publike Shqiptare - Përforcimi dhe zgjerimi i HRMIS-

it” (baza e të dhënave të punonjësve publikë). Objektivi i këtij projekti është të forcojë kapacitetet menaxhuese të burimeve njerëzore të administratës publike shqiptare, duke nxitur aftësitë për implementimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, si dhe të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, me qëllim përgatitjen e vendit për anëtarësimin në BE.

- Është asistuar nga Banka Botërore (PARP, gjatë vitit 2005) në kuadër të “Trust Fund”, mbi “Zhvillimin e Bazës së të dhënave për shërbimin civil”. Pas përfundimit të fazës së parë, e cila përfshinte hedhjen e të dhënave nga Kryeministria dhe ministritë e linjës, u vijua me fazën e dytë, e cila përfshiu shtrirjen e këtij sistemi në institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit dhe Ministrave të linjës, si dhe institucionet e pavarura.

Po kështu, në kuadër të programit CARDS 2004 të Bashkimit European, DAP dhe ITAP janë asistuar për:

- a) Rikonstrukcionin dhe pajisjen e ndërtesës së re të ITAP-it,
- b) Asistencën teknike për zhvillimin e sistemit të trajnimit të nëpunësve civilë.
- c) Pajisje IT për rrjetin qeveritar, ku dhe DAP përfitoi një asistencë teknike (pajisje teknike), nga Agjencia Kombëtare për Zhvillimin e Informacionit.

Gjithashtu, edhe Fondacioni SOROS në Tiranë, ka asistuar Departamentin e Administratës Publike për mbështetje financiare në fushën e qeverisjes elektronike. Ky projekt kishte si objektivi, modernizimin e mëtejshëm të administratës publike dhe afrimin me nevojat e publikut të gjerë. Zhvillimi i e-Qeverisjes u bazua në Strategjinë Kombëtare të Teknologjisë së Informacionit hartuar nga Qeveria Shqiptare në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

Zhvillim (PNUD) dhe planet e Qeverisë për një administratë transparente dhe efektive në kohë reale.

Projekti ishte hartuar në formën e një asistence teknike dhe transferim eksperience (know-how) dhe si vend i preferuar për bashkëpunim u zgjodh Estonia, duke qenë se Estonia përveç se ka pasur arritje të konsiderueshme në këtë fushë, ka shumë ngjashmëri me vendin tonë, si në proceset historike, ashtu dhe në ato të punës.

**Sistemet Elektronike të Manaxhimit të Dokumentacionit, një mbështetje e fuqishme për zbatimin e shërbimeve të e-qeverisjes.**

**DR. SILVANA MARTINI**

*Universiteti i Tiranës,  
Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Matematikës, Statistikës dhe  
Informatikës së Zbatuar  
Email: silvi@icc-al.org*

**Abstrakt**

Që nga fillimi i viteve 1990, zhvillimi i teknologjise së komunikimit dhe informacionit dhe përfitimet që vinin prej tij krijuan një proces që rezultoi në një numër iniciativash si europë, europe 2002, europe+, europe 2005 te cilat kanë një qëllim të përbashkët – të sigurojnë një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e Europës. Shërbime të reja, aplikime si edhe tregje të rinj i hapën rrugën mundësive të reja në këtë drejtim. E-qeverisja mund të shihet si një nga shërbimet e reja që përfaqëson një akses të thjeshtë dhe ripërdorim të informacionit të sektorit publik dhe përgjigje ndaj nevojës për rritje të standardeve të procesit të administrimit për qytetarët dhe bizneset. Sfidat kryesore në shërbimin e e-qeverisjes janë: ngritja e proceseve të biznesit që në mënyrë eficiente mbështeten nga teknologjia moderne e telekomunikimit dhe informacionit, organizimi dhe shkëmbimi elektronik ndërmjet institucioneve, edukimi i punonjësve civile, inkurajimi dhe edukimi i qytetarëve për përdorimin e shërbimeve të reja. Në këtë artikull autorët paraqesin rezultatet e zbatimit të Sistemit Elektronik të Manaxhimit të Dokumentacionit në disa nga institucionet kryesore publike në Shqipëri dhe tregojnë relacionin midis avantazheve dhe disavantazheve të EDMS-ve dhe shërbimeve të e-qeverisjes.



**Keywords.** Shoqëria e informacionit, e-urope, e-Qeverisje, shërbimet e e-qeverisjes, EDMS, shërbime publike, ICT.

## **Hyrje**

Në themel Teknologjitë e Komunikimit dhe të Informacionit - ICT-të janë instrumente të trajtimit të informacionit – një seri pajisjesh, aplikimesh dhe shërbimesh që përdoren për të prodhuar, ruajtur, përpunuar, shpërndarë dhe shkëmbyer informacion. Ato përfshijnë ICT-të “e vjetra” si radio, televizion, telefon, dhe ICT-të e reja si kompjuterat, teknologjitë satelitore, komunikimet “pa tel” dhe internetin. Këto instrumenta të ndryshëm janë të aftë të punojnë së bashku dhe të kombinohen me njëri-tjetrin për të formuar atë që quhet “rrjeti botëror” – një infrastrukturë masive e shërbimeve të ndërlidhura telefonike, aparaturash llogaritese të standardizuara, interneti, radio dhe televizioni, e cila shtrihet deri në çdo skaj të globit.

Potenciali revolucionar i ICT-ve të reja e ka zanafillën në kapacitetet për të vënë në komunikim në çast një numër të madh rrjetesh, organizatash dhe individesh në distanca të mëdha gjeografike dhe me kosto shumë të ulët. Në këtë mënyrë, duke lehtësuar “rrjedhjen” e informacionit, kapitaleve, ideve, njerëzve dhe produkteve nëpër të gjithë botën, ICT-të janë bërë faktor kyç të globalizimit. Ato kanë transformuar biznesin, tregjet dhe format e organizimit, kanë revolucionarizuar proceset e të mësuarit dhe përhapjes së diturive, kanë fuqizuar komunitetet dhe individët, dhe kanë nxitur rritje ekonomike të qëndrueshme në shumë vende të botës.

Tani teknologjitë e informacionit dhe komunikimit po bëhen gjithmonë e më shumë themeli, mbi të cilin ngrihen shoqëritë dhe ekonomitë tona. Zgjerimi i përdorimit të ICT-ve për zhvillim të shoqërisë kërkon rritje të ndërgjegjësimit dhe pranim të idesë në të gjitha nivelet

e shoqërisë.

Vendimmarresit dhe gjithë të interesuarit duhet të marrin vendime të drejta mbi llojin e teknologjive që u përshtaten më mirë nevojave dhe kontekstit, në të cilin do të përdoren. Megjithatë, për shumicën e njerëzve – edhe për ata që përdorin me lehtësi kompjuterin dhe internetin – aspektet teknologjike të ICT-ve mund të jenë “të frikshme”.

Për më tepër, veçanërisht në vendet me nivel arsimimi të ulët, me infrastrukturë telekomunikacioni të dobët, të paelektrifikuara dhe me nivele të larta borxhi, lidhja ndërmejt ICT-ve dhe sfidave të zhvillimit nuk është gjithnjë e lehtë të pranohet në opinion.

Të kuptuarit e saktë se si ICT-të mund të vihen në shërbim të objektivave të zhvillimit kërkon njëkohësisht njohje të mirë të vetë ICT-ve dhe vlerësim “me këmbë në tokë” të mënyrës se si ato mund të përdoren për zgjidhjen e problemeve konkrete. Në nivelin kombëtar, futja e këtyre teknologjive në shërbim të zhvillimit është një përpjekje komplekse shumë sektoriale, që kërkon analizë të thellë, vullnet politik dhe veprime të koordinuara në një spektër të gjërë sektorial dhe ndërmjet shumë aktorësh. Të gjithë partnerët e interesuar – qofshin vendimmarrës të nivelit të lartë apo përfitues në zonat rurale – duhet të mbajnë parasysh që teknologjitë të jenë të përshtatura me nevojat konkrete. Partnerët e interesuar në këto procese janë:

**Nivelet më të larta të qeverisjes:** vendimmarrësit që janë përgjegjës për vizionet e zhvillimit, marrjen e iniciativës, përgatitjen e kuadrit ligjor dhe kuadrit të politikave të zhvillimit.

**Nivelet e mesme të qeverisjes:** drejtuesit, administratorët e sektorëve (institucioneve/ministrive të linjës), të cilët shpesh janë inisiatorët e

përdorimit të ICT-ve. Administratorët/ drejtuesit e nivelit të mesëm mund të jenë identifikuesit dhe nxitesit e inisiativave të reja, veçanërisht kur ata vetë janë njohës të mirë të potencialit të ICT-ve.

**Sektori privat:** i cili zotëron kapacitetet investuese dhe inovative më të fuqishme, me kusht që klima për zhvillimin e tyre të jetë e favorshme. Sektori privat mund të jetë motori më i fuqishëm për zhvillimin e ICT-ve, për rritjen e qëndrueshme të përdorimit dhe zgjerimin e rrethit të përfituesve.

**OJQ-të dhe format e organizimit të shoqërisë civile:** janë shpesh inisiatore të rëndësishëm, zbatues, ndërmjetës dhe përfitues të projekteve të ICT-ve, veçanërisht për ato projekte që kanë për objektiv akses të gjërë si dhe për ato që përfaqësojnë përpjekje me orientim më të theksuar drejt zhvillimit.

Për të perfituar nga zhvillimi dhe përdorimi i gjerë i ICT-ve Bashkimi Europian vendosi të ndërmarrë disa aksione konkrete. Rezultat i kësaj është një iniciativë politike e quajtur eUrope, fokusi kryesor i së cilës është të fusë Europën dhe qytetarët e saj në shoqërinë e re të informacionit.

### Realiteti kombëtar i zhvillimit të teknologjisë

Mjedisi (backgroundi) historik i Shqipërisë karakterizohet nga vendimmarrje të kushtëzuara nga faktorët politikë dhe ideologjikë, duke lënë në hije sistemet e informacionit dhe teknologjinë.

Pas Luftës së Dytë Botërore një regjim diktatorial mbretëroi në Shqipëri për 45 vjet.

Një karakteristikë e këtij regjimi dhe, në njëfarë mënyre shkaku kryesor i shembjes spektakolare, ishte një politikë manaxhimi bazuar më tepër në faktorë ideologjikë dhe politikë se sa në ato ekonomikë. Ambienti nën këtë politikë ishte një shoqëri ku shteti gradualisht mori

pronësinë e çdo njësie shoqërore, ekonomike, shkencore, edukative, etj. Paralelisht me strukturat shtetërore ekzistonte struktura e partisë që ishte manaxheri real i administratës dhe ndërmarrjeve publike.

Si rezultat, edhe kur një infrastrukturë moderne rrjeti kompjuterik u ndërtua kryesisht aplikimet e manaxhimit dhe të financës, nuk u përdor kurrë përveç se për probleme teknike dhe shkencore.

Pas shembjes së diktaturës, një fenomen i ri u zhvillua. Para së gjithash, ishte rindërtimi i strukturave të shtetit dhe administratës publike, për të realizuar kalimin drejt një shoqërie demokratike dhe një tregu të lirë të hapur. Në këtë kohë paqëndrueshmëria politike dhe ndryshimet e shpeshta të personelit brenda sektorit publik, përshtjellimi brenda legjislacionit dhe brenda mendjeve të njerëzve, dhe e gjitha kjo çoi në një kaos real dhe global. Një aspekt i këtij kaosi ishte mangësia e rregullave të punës dhe formalizimit të informacionit brenda institucioneve publike. E gjitha kjo e bënte të vështirë zbatimin e IS moderne dhe përdorimin efektiv të ICT.

Vendi u hap drejt një teknologjie të re moderne përfshirë kompjuterat dhe rrjetet kompjuterike. Në mënyrë të veçantë projekte dhe ndihma internacionale mbështetën futjen e PC-ve të reja. Sektori publik nuk kishte praktikisht asgjë me përjashtim të një numri të vogël PC në përdorim, që ishte në një kontrast të plotë me vendet e zhvilluara prej nga vinin ndihma dhe ide të reja. Kjo situatë krijoi iluzionin që vetëm duke instaluar kompjuterat gjërat mund të shkonin më mirë dhe, formalisht kjo gjë ndodhi. Për fat të keq një vëmendje e vogël u tregua ndaj vetë IS-ve, që është mënyra e mbledhjes, përpunimit dhe qarkullimit të informacionit të përdorshëm në vendimmarrje.

Në shekullin e 21, ku globalizmi dhe teknologjia luajnë një rol shumë të rëndësishëm në integrimin e vendeve dhe ekonomive dhe

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

përmirësimin e jetesës së njerëzve në të gjithë globin, Shqipëria ka njohur Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit si një mjet për zhvillimin social ekonomik, bashkëpunimin rajonal dhe integrimin në Europë.

Aktualisht Shqipëria është akoma mbrapa mesatares së përgjithshme të niveleve të vendeve të Europës Lindore për sa i përket zhvillimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit .

Qeveria Shqiptare duke qenë e përgjegjshme për nevojën e përdorimit të gjerë të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në mbarë vendin, miratoi në vitin 2003, Strategjinë Kombëtare të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për Shqipërinë. Kjo strategji është hartuar brenda kuadrit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit me Bashkimin European dhe aktiviteteve rajonale në kuadër të Paktit të Stabilitetit.

Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (ICT-të) janë mjete të fuqishme, të cilat do të ndihmojnë zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe social të Shqipërisë. Ajo çka është më e rëndësishme nuk janë mjetet në vetvete, por mënyra se si njerëzit dhe institucionet së bashku vendosin t'i përdorin ato për të përmirësuar aksesin dhe shpërndarjen e informacionit për një pjesëmarrje më të madhe në dialog, arsim, tregti, qeverisje, etj.

### **Manaxhimi Elektronik i Dokumentit**

Sistemet e Manaxhimit të Dokumentave kanë aftësinë të manaxhojnë përmbajtjen kritike, vendimtare të ndërmarrjes – nga dokumentat elektronike, email-et, dhe multimediat në letër, figura, formularë

dhe regjistrime. Ato optimizojnë përdorimin e dokumentave brënda një organizate. Sistemet e Manaxhimit të Dokumentave sigurojnë një depozitë dokumenti të bashkuar me metadata<sup>1</sup> të fuqishme që përshkruajnë përmbajtjen që ato përmbajnë. Sistemi gjurmon historinë editoriale të çdo dokumenti dhe relacionet e tij me dokumenta të tjerë. Një Sistem Manaxhimi Dokumenti siguron mundësinë për të reduktuar pengesat për ndarjen e informacionit dhe furnizon pasuritë e eksperiencës të ruajtura në depozitat e kujtesës së korporatës. Ky mjedis bashkëpunues manaxhimi dokumenti mund të jetë pagabueshmërisht i sigurtë, duke siguruar akses të besueshëm për të kapur, organizuar, gjetur dhe shpërndarë informacion. Duke zbatuar një Sistem Manaxhimi Dokumenti, punonjësit brënda organizatës, po ashtu si edhe ato jashtë saj, mund të kenë akses të sigurtë në përmbajtjen dhe burimet që i japin atyre aftësinë për të vepruar shpejt në atmosferat evoluese të biznesit. Kjo mund të nënkuptojë që përdoruesit marrin informacionin e duhur kur dhe ku atyre u nevojitet – duke lehtësuar gjykimin dhe siguruar shkathtësinë për t'i bërë më të shpejta vendimet efektive.

Implementimi i një Manaxhimi Elektronik Dokumenti nuk është i parëndësishëm dhe mund të paraqesë shumë sfida tek një organizatë. Proçesi i krijimit dhe çdo proces rishikimi, nëpër të cilat një dokument kalon mund të përfshijë bashkëpunimin e shumë punonjesve nga shumë disiplina. Pasi dokumentat mund të ekzistojnë për shumë vite, çdo dokument mund të kalojë përmes shumë rishikimeve gjatë jetes së tyre.

Një Sistem Manaxhimi Dokumenti i fuqishëm është një aplikim i bazuar mbi rregulla që është projektuar për të drejtuar këto sfida. Fleksibiliteti i tij i jep mundësinë kompanisë të përcaktojë nivelin e kontrollit që ajo do të ushtrojë mbi krijimin, modifikimin dhe

<sup>1</sup> Metadata ose “e dhëna rreth të dhënës” përshkruan përmbajtjen, cilësinë, gjendjen dhe karakteristika të tjera të të dhënës.

shpërndarjen e dokumentave të rëndësishme.

Sistemi siguron që çdo dokument i kontrolluar të jetë i saktë, i përditësuar dhe i disponueshem tek të gjithë njerëzit e duhur në kohën e duhur.

### ***Roli i e-DMS-ve për e-Qeverisjen***

Qeverisja Rajonale (sipas ligjit) ka kompetenca në fushat e :

- a) edukimit;
- b) shëndetësisë;
- c) planifikimit urban dhe zonal;
- d) zhvillimit ekonomik;
- e) infrastrukturës së trafikut dhe rrugës;
- f) planifikimit dhe zhvillimit të edukimit, shëndetësisë, shoqërisë dhe institucioneve kulturore.

Kjo do të thotë që qeverisja duhet të krijojë modelin dhe specifikimet e shërbimeve për qytetarët e saj nëpërmjet planifikimit strategjik dhe krijimit të politikave publike. Kjo do të thotë gjithashtu, që shërbimet e drejtëpërdrejta të sigurohen kryesisht nëpërmjet institucioneve që janë në varësinë e qeverisë.

Qeverisja ka një rrjedhë shumë intensive informacioni të brendshme dhe të jashtme. Informacioni zakonisht, është në letër dhe kjo sjell shumë vështirësi.

Përdorimi i e-DMS-ve siguron një mbështetje të fuqishme për e-qeverisjen në aritjen e disa objektivave:

- Objektivi i Parë: Relacione më të mira midis Qeverisë dhe Qytetarëve.
- Objektivi i Dytë: Kalimi progresiv nga modeli burokratik i

intensifikim të decentralizimit.


*Vizioni i përdorimit të këtyre sistemeve është : zyrat pa letra.*

Sipas këtij sistemi çdo dokument biznesi që është në letër mund të jetë i dixhitalizuar; për përdorim të brendshëm nuk lejohen dokumenta të printuara.

Pas implementimit të këtij sistemi i gjithë komunikimi dhe dokumentacioni i brendshëm duhet të jetë vetëm elektronik. Të gjithë dokumentet e biznesit duhet të jenë të arkivuar në mënyrë elektronike, me përjashtim të atyre që duhet të përdoren për qëllime ligjore. Dokumentat në letër janë krijuar vetëm për komunikime me palën e tretë ose për qëllime ligjore.



## Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I



administrimit në një model objektivash dhe rezultatesh me metrika zhvilluese.

- Objektiva e Tretë: Mbështetje e rolit strategjik të Qeverisë dhe në mënyrë të vazhdueshme

## Koncepti i Sistemit Elektronik të Manaxhimit dhe Arkivimit të Dokumentit (e-DMS)

### - Përfitimet që vijnë nga përdorimi i e-DMS-së

#### *Përpunime më të mira & Ulje e Koshtos Operacionale*

- Hapësirë më e vogël e kërkuar për arkivimin e dokumentit.
- Kërkim dhe Rikthim i thjeshtë (timeless) i dokumentit.
- Më pak kohë e shpenzuar në rrugët e brendshme.
- Rjedhë pune e biznesit më efiçente.
- Një pikë e vetme arkivimi për të gjithë dokumentat që hyjnë dhe dalin.
- Shërbime të përmirësuara për klientët.
- Ulje e koshtos në krijimin e dokumentave të fotokopjuara.
- Më pak gabime llogaritjeje dhe procedura më të shpejta kontrolli (auditimi).
- Dixhitalizim dhe përdorim i Arkivës Historike.

#### *Siguria*

- Ruajtje e përherëshme dhe e pandryshueshme e dokumentave dhe skedarëve.
- Ruajtje e sigurtë e dokumentave nga katastrofa të mundshme natyrore.
- Rritje e sigurtisë së aksesimit nëpërmjet përdorimit të Aqess Control Lists dhe/ose përdorimit të nënshkrimit elektronik.
- Arkivim i sigurtë i vetive të skedarëve elektronikë.
- Arkivim i sigurtë i të gjithë versioneve të reja të dokumentave.

***Krijimi i infrastrukturës së Teknologjisë së informacionit***

- Mundësia e përdorimit të përpunimeve elektronike.
- Infrastrukturë për e-biznes.
- Infrastrukturë për Rjedhë Punë Automatike (Automatic Workflow).
- Infrastrukturë për përgatitjen e dokumentave për ERP-në.
- Pavarësi gjeografike e aksesimit të dokumentit nëpërmjet intranet/Internet.

**Situata e e-DMS-ve në Shqipëri**

Për momentin vlerësohet që rreth 10-15% e institucioneve dhe kompanive në Shqipëri përdorin e-DMS . Kjo, për arsye se shumica e pjesës prej 85% që nuk përdorin e-DMS nuk e kanë idenë që ekziston një sistem i tillë manaxhimi dokumentacioni, (sidomos në institucionet shtetërore); një pjesë tjetër ka dëgjuar të flitet por, nuk beson se një gjë e tillë mund të realizohet dhe e lenë atë pasdore; një pjesë tjetër ka frikë se një sistem i tillë do të jetë shkas për manipulime dhe e paragjykojnë duke mos u interesuar për një gjë të tillë; ndërsa një pjesë tjetër thjesht nuk kanë mundësi financiare për të investuar në një sistem të tillë, (me mundësitë financiare theksojmë se nuk është vetëm kosto e blerjes së sistemit, por koston më të madhe e ka konvertimi i gjithë dokumentacionit ekzistues në letër në format elektronik; për këtë nevojitet staf dhe shumë orë pune si dhe mirëmbajtje e sistemit nga inxhinierë të specializuar për këtë punë). Përsa i përket sektorit privat, situata është disi më e pranueshme pasi, janë më të avancuar në mentalitet sesa institucionet shtetërore, kanë më pak “letra” si dokumentacion që do të thotë se janë më fleksibël dhe kanë më pak kosto për ta implementuar si sistem.

## **Problematika që ndeshet për futjen dhe zbatimin e e-DMS-ve**

Problemi i parë është “injanca” që ka shumica e tregut rreth sistemeve informatike në përgjithësi. Kjo pjesë, mbase nuk e di se ekziston një sistem i tillë, i cili është shumë i dobishëm për konsumatorin (kompanitë, institucionet), pasi u kursen atyre shumë kohe dhe kosto (letër, bojë printeri & fotokopjeje) në manaxhimin e dokumentacionit.

Problemi i dytë është varfëria e tregut shqiptar, i cili akoma nuk është në gjendje plotësisht të përballojë kostot e futjes së një sistemi të tillë në masë. Edhe ajo pjesë e tregut që e njeh sadopak vlerën e këtij sistemi nuk ka aq burime financiare sa të investojë paraprakisht në e-DMS për t’i marrë më pas fitimet. Kjo gjë lidhet dhe me faktin që implementimi i një sistemi të tillë kërkon kushte paraprake të tilla si pasja e disa PC-ve në kompani, mundësisht të një serveri, pasja e një LAN-i dhe patjetër të një stafi të aftë për mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve. Kjo gjë e rrit dhe më tepër koston e e-DMS-ve .

Problemi i tretë që haset ka të bëjë me ofruesit e shërbimit të EDMS apo më saktë kompanitë që e tregtojnë si sistem. Shumica e tyre bën punë jo korrekte duke shfrytëzuar pikërisht mungesën e informacionit që ka klienti rreth kësaj zgjidhjeje. Në rast se p.sh. një institucion vendos të investojë në realizimin e një sistemi të tillë, shumica e kompanive që hyjnë në tender (blerja realizohet detyrimsht me tender, pasi kosto i kalon 300 000 lekët ) hyjnë me qëllimin për ta ulur sa më shumë çmimin në mënyrë që ta fitojnë tenderin dhe, më pas, ajo që kjo kompani fituese ofron është shumë larg kërkesave të vetë sisemit e-DMS. Me fjalë të tjera ajo që ata implementojnë është një pjesë e e-DMS (jo e tërë e-DMS me gjithë funksionalitetet e saj) dhe, për më tepër, këto kompani në mënyre jo korrekte u imponohen institucioneve me idenë që kjo kështu realizohet dhe ndodh një situatë qesharake dhe për të ardhur keq; nuk është klienti ai që përcakton me anë të nevojave

të tij se si do të jetë llogjika e funksionimit të sistemit e-DMS, por janë këto kompani jo korrekte, të cilat imponojnë një llogjike të manaxhimt të dokumentacionit, llogjikë krejt ndryshe, në shumicën e rasteve, nga ajo që ka nevojë klineti. Kjo vjen kryesisht si pasojë, mungesës së informacionit të stafit IT të një kompanie apo insitucioni. Sidomos ky problem është i theksuar në institucionet shtetërore, pasi procedurat e tenderit janë shumë të gjata dhe shpesh herë për t'ju kthyer përsëri nga e para një tenderi të dështuar do shumë kohë, kohë të cilën nuk e kanë dhe për të mos humbur investimin, apo fondin nga buxheti i shtetit për këtë investim që kishin ndërmend të bënin, e lënë ashtu siç është. Duke ditur këtë fakt disa kompani që ofrojnë e-MDS qëllimisht e zgjasin kohën e implementimit të e-DMS-së tek institucioni me qëllim që atyre të mos u mbetet më kohë për ta prishur kontratën me këtë kompani dhe për ta filluar komplet procedurën e tenderimit nga e para.

### **Perspektiva e e-DMS-ve në Shqipëri**

E ardhmja e EDMS shihet të jetë pozitive, pasi me kalimin e kohës edhe mungesa e informacionit e pjesës më të madhe të administratës shtetërore dhe e stafit të kompanive private do të largohet dhe normalisht vetë teknologjitë e reja që kanë hyrë dhe do të vazhdojnë të hyjnë në sektorin privat dhe atë shtetëror do të çojnë patjetër drejt integritit të tërë dokumentacionit në format elektronik.

Rëndësi kryesore, në radhë të parë ka kualifikimi i stafit, pasi implementimi i një sistemi e-DMS kërkon që nga ana e klienti të ketë një logjikë të qartë dhe të përvijuar saktë se si do të manaxhohet dokumentacioni. Pa këtë logjikë, stafi ose nuk do të dijë të orientohet (ku janë dhe si t'i gjejnë dokumentat), ose në rastin më të mirë do të shtrëngohen të zbatojnë logjikën e imponuar nga kompania që i ka ofruar sistemin.

Rëndësi së dyti ka infrastruktura, pasi ajo është diçka që instalohet në mënyrë standarde. Rrjetat apo LAN-et kanë një topologji të caktuar shumë të njohur dhe janë krejt transparente të përballojnë çdo lloj sistemi qoftë dhe e-DMS. Një kompanie që do të implementojë e-DMS dhe që nuk ka infrastrukturën e nevojshme, nuk do t'i duhet gjë tjetër veçse të bëjë disa llogari të thjeshta për koston që ka në vit duke manaxhuar dokumentacionin me letra, bojra printeri, fotokopje, energji elektrike, kohë e humbur pune.... e me rradhë dhe koston që do të ketë instalimi i LAN-it me një numër PC-sh, me një kosto e-DMS dhe një kosto stafi për mirëmbajtje. Nga anon peshorja andej do të drejtohet edhe përparësia. Gjithsesi implementimi i infrastrukturës LAN është një fraksion i instalimit të e-DMS-së.

- Në një rast tipik, kosto e një sistemi e-DMS shkon mesatarisht 20 000 – 30 000 EURO, ndërsa instalimi i një rrjeti me 10 PC, (të cilat nuk shërbejnë vetëm për e-DMS, por edhe për punët e tjera) nuk i kalon 5 000 EURO.

Gjithësesi e-MDS është diçka që do të hyjë ndjeshëm në tregun shqiptar, i cili mundet vetëm ta shtyjë si kohë këtë hyrje në masë, shtyrje që vjen nga varfëria e tij.

### **Metodologjia**

Për të analizuar situatën aktuale në Shqipëri u realizua një pyetsor në disa nga institucionet shtetërore kryesore. Pyetsori përmban pyetje që lidhen me teknologjinë, nivelin e rrjetave dhe sistemet e-DMS.

Disa institucione shtetërore që kanë implementuar ose janë duke punuar në implementimin e sistemit e-DMS janë: Ministria e Drejtësisë (SharePoint e realizuar me Cactus), Ministria e Mbrojtjes (Oracle realizuar nga Infotech), Ministria e Financës (Docushare Xerox),

Drejtoria e Tatimeve (platforma ASP.Net realizuar me Alfa XP), Ministria e Integritimit (SharePoint realizuar nga Infosoft), Këshilli i Ministrave (Sharepoint realizuar me Microsoft & Nextesence, Maqedoni).

Në Shqipëri ka disa kompani lokale që ofrojnë e-DMS, si: Infosoft, Cactus, Intech+, Alfa XP, ArkIT, Datech.

## **Rezultatet e Pyetsorit**

### **Niveli i hardware-ve:**

- 40.7% mendojnë që është shumë i mirë.
- 33.3% mendojnë që është i mirë.
- 22.27% mendojnë që është i pranueshëm.
- 3.7% mendojnë që është i ulët.

### **Niveli i software-ve:**

- 37% mendojnë që është shumë i mirë.
- 37% mendojnë që është i mirë.
- 8.5% mendojnë që është i pranueshëm.
- 7.4% mendojnë që është i ulët.

76.95 e organizatave të përfshira në anketim kanë një Intranet dhe vetëm 23.1% nuk kanë.

Prej atyre që nuk kanë Intranet, 62.5% kanë projekt për krijimin e tij. Organizatat e përdorin intranetin për të siguruar shërbimet e mëposhtme:

- Shkëmbimi të dhënave dhe informacionit.(74.1%)
- Ndarje e pajisjeve të printimit. (74.1%)
- Shërbime e-mail service.(81.5%)
- Manaxhim i dokumentacionit.(59.3%)
- Organizim i rrjedhës së punës. (29.6%)
- Ruajtje dhe arkivim.(55.6%)

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

Nga këto organizata:

- 60% përdorin e-DMS
- 40% nuk e përdorin atë.

Organizatata përfitojnë nga përdorimi i e-DMS disa avantazhe:

- Shpërndarje dhe gjetje më e shpejtë e dokumentacionit (48.1%)
- Transparencë e veprimeve të biznesit (29.6%)
- Përqendrim dhe aksesibilitet i kapitalit intelektual të kompanisë (18.5%)
- Centralizim i arkivimit: aksesibilitet, siguri dhe kontroll (33.3%)
- Proces më i thjeshtë i vendimmarrjes (29.6%)

Nga ata që aktualisht nuk përdorin e-DMS, 75% kanë një projekt për këtë sistem dhe 25% nuk kanë projekt.

Lidhur me vizionin e organizatave për të ardhmen e e-DMS-ve në Shqipëri:

- 11.1% mendojnë që është në një nivel të pranueshëm.
- 48.1% në një nivel të mirë.
- 40.7% në një nivel shumë të mirë.

### ***Konkluzione***

- Qeverisjet e të gjitha niveleve kuptojnë që e gjithë shoqëria mund të përfitojë nga teknologjia e komunikimit dhe informacionit.
- Për të implementuar këtë teknologji po bëhen përpjekje për të ristrukturuar proceset e biznesit dhe për të siguruar shërbime më të mira me qytetarët dhe subjektet e biznesit.
- Qeverija shqiptare po ndërmerr masa për të transformuar shoqërinë shqiptare në një shoqëri informacioni, por këto masa nuk përfshijnë qeverisjet lokale dhe rajonale.
- Institucionet shtetërore vendosin të investojnë në e-DMS dhe



## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

përpiqen të përdorin teknologjinë e informacionit dhe komunikimit sa më shumë të jetë e mundur.

- Bazuar në statistika, një e-DMS mund të reduktojë koston e përpunimit të dokumentacionit në 80%. Në të njëjtën kohë, përmirësohet siguria dhe zvogëlohet numri i gabimeve.

- Suksesi në projektin e e-DMS varet në implementimin e tij.

- E ardhmja e e-DMS në Shqipëri duket të jetë pozitive.

- Klientët më të mëdhenj dhe përdoruesit kryesorë të e-EDMS në Shqipëri mbeten institucionet shtetërore dhe kompanitë e mëdha të biznesit.

- Si pasojë e rolit të rëndësishëm në të gjitha proceset, e-DMS është themeli i shërbimeve të e-Quverisjes në qeverisjen rajonale.

## **Literatura**

1. Ann Rockley, Pamela Kostur and Steve Manning, “Managing Enterprise Content - A Unified Content Strategy ”, 2003, ISBN 0-7357-1306-5
2. Roger T. Burlton , “ Business Process Management”, Sams, 2008
3. David J. Skyrme, “Knowledge Networking: Creating the Collaborative Enterprise”, Butterworth-Heinemann, 1999, ISBN-13: 978-0750639767
4. Andrew Bailey, article “Document Management Return on Investment (ROI) Analysis”, 2009
5. James Boyle, “A good Electronic Document Management System can bring together document storage, work flow and indexing”, Byte, Volume 22 Number 5, 1997, ISSN: 0360-5280
6. Neki Frasheri, paper, “Recent Its Development In Albania – New Trends And New Problems”, 2007
7. Gehry Cleveland, “Document Management Systems”
8. Miles L. Mathieu, Ernest A. Capozzoli, “The Paperless Office: Accepting Digitized Data”, 2003
9. Hilgen, D., “Going paperless”. Best’s Review, 101(3), 124-127. 2000
10. [www.gartner.com](http://www.gartner.com)
11. [www.groovecommunications.com](http://www.groovecommunications.com)
12. [www.pwc.com](http://www.pwc.com)
13. [www.arma.org](http://www.arma.org)

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*

## *Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa I*



